

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6059
E premte, 10 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Liderët politikë nga Lugina
kërkojnë përfshirjen në
bisedimet Kosovë - Serbi

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS, PA KONSENSUS PËR RATIFIKIMIN
E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE | FAQE 4-5

PËR HERË TË TRETË KUVENDI DËSHTON T'I RATIFIKOJË MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur as për herë të tretë t'i ratifikojë pesë marrëveshje ndërkombëtare. Ratifikimin e këtyre marrëveshjeve nuk e kanë mundur as votat e PDK-së. Lëvizja Vetëvendosje nuk i ka

përkrahur këto marrëveshje, ndërsa disa deputetë të pozitës nuk kanë marrë pjesë në votim për shkak të infektimit me Covid-19. Për këtë arsye, ka nisur të shqyrtohet mundësia e ndryshimit të Rregullores së

Punës së Kuvendit të Kosovës në mënyrë që të mundësohet votimi në distancë. Sipas Qeverisë, pa ratifikimin e këtyre marrëveshjeve është i pamundur zbatimi i Pakos Fiskale Emergjente



VETERANËT E UÇK-së KUNDËRSHTOJNË SPECIALEN

Me maska dhe duke respektuar distancën fizike, veteranët e ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë kundërshtuar pretendimet e Gjykatës Speciale për ish-luftë-

tarët e UÇK-së. Me moton "Në mbrojtje të luftës çlirimtare", me nga 99 persona, protesta është mbajtur në të gjitha komunat e Kosovës. Ata e kanë vlerësuar të padrejtë

publikimin e propozimaktakuzës për presidentin Hashim Thaçi dhe liderin e PDK-së, Kadri Veseli. Sipas tyre, aktakuza është politike dhe goditje për shtetin e Kosovës

NË SPITALET E KOSOVËS PO TRAJTOHEN 268 PACIENTË ME COVID-19

FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT

**DRITA VAZHDON RRUËTIMIN
DREJT TITULLIT** F. 6

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

**KOSOVA KA HISTORI
TË SHENJTËRUAR, ASGJË
NUK E ZBEH ATË** F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

**QEVERIA E KOSOVËS NUK E
MBËSHTETË NISMËN LIGJORE
PËR LUFTIMIN E PANDEMISË** F. 6

**NË MJEDISET ME SHUMICË
SERBE NË KOSOVË, 258 TË
INFEKTUAR ME COVID-19** F. 6

EKONOMI

**RUKIOI, THIRRJE DEPUTETËVE:
SA MË PARË TË ADRESOHEN
KËRKESAT E SEKTORIT PRIVAT** F. 8

**ULET NORMA E AKCIZËS
PËR LËNGJET DHE VETURAT
HIBRIDE** F. 8

KULTURË

**MINISTRJA DUMOSHI
TAKON ANËTARËT
E KËSHILLIT TË LIBRIT** F. 3



Në spitalet e Kosovës po trajtohen 268 pacientë me Covid-19



PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka njoftuar të enjten se 268 pacientë të infektuar me Covid-19 janë duke u trajtuar në klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe në shtatë spitalet e përgjithshme. Prej tyre, thuhet në njoftim, 166 pacientë ndodhen në klinikat e QKUK-së dhe 102 në spitalet e përgjithshme. Në Klinikën Infektive të QKUK-së bëhet me dije se janë gjithsej 100

raste, prej tyre 61 me oksigjenoterapi, ndërsa dy raste më të komplikuara ndodhen në mjekimin intensiv të kësaj klinike.

Dyzet e katër pacientë, që të gjithë me oksigjenoterapi, janë duke u trajtuar në Klinikën e Pulmologjisë, ndërsa në njësinë intensive të Mjekësisë Sportive janë të shtrirë 22 pacientë, katër prej tyre të intubuar.

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës po ashtu bën të ditur se në Spitalin e

Prizrenit janë të shtrirë 24 pacientë me Covid-19, në Pejë 42, në Gjakovë 19, në Ferizaj 6, në Gjilan 5 dhe në Mitrovicë 6, ndërsa në Spitalin e Vushtrrisë për momentin nuk ka raste të konfirmuara.

Kosova, që prej shfaqjes së rasteve të para me Covid-19 më 13 mars deri më 8 korrik, ka të konfirmuar gjithsej 4 100 raste pozitive të të infektuarve me Covid-19. Prej tyre, 86 pacientë kanë humbur jetën, ndërsa 2 063 janë shëruar.

Ministri gjerman: Kosovës duhet t'ia japim vizat që ia premtuam

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministri gjerman për Evropë, Michael Roth, ka deklaruar se duhet të liberalizohen vizat për qytetarët e Kosovës. Në një shkrim për "Die Welt", Rothi ka thënë se situata në Ballkanin Perëndimor edhe më tej mbetet e brishtë. Sipas ministrit gjerman, pajtimi në rajon është faktor kyç për paqen dhe ndryshimin, për një perspektivë të mirë në Ballkanin Perëndimor. "Për sa i përket rolit të BE-së, është e qartë: Ne kemi një përgjegjësi të veçantë për oborrin e shtëpisë evropiane. Ne duhet të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë për hir të paqes, pajtimit dhe demokracisë në Ballkanin Perëndimor. Posaçërisht kur bëhet fjalë për të rinjtë, Evropa e bashkuar e vlerave të përbashkëta nuk e ka humbur shkëlqimin. Prandaj ne duhet që fuqinë tonë transformuese ta shfrytëzojmë me mençuri dhe t'u tregojmë njerëzve në rajon, se mund të llogarisin në ne. Edhe më e rëndësishme ishte që në Samitin e BE-së në maj, edhe pse u gjendëm në mes të provës stresuese të krizës që shkaktoi Korona, edhe një herë pangatërrueshëm dhe shumë

qartë theksuam se: E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në BE", ka shkruar ai. Ai ka thënë se duke hedhur shikimin nga Kosova, "ne si BE duhet të japim atë që kemi premtuar dhe më në fund të përparojmë në rrugën e liberalizimit të vizave".

Më tutje, Rothi ka folur edhe për prioritetet e Gjermanisë në Këshill të Bashkimit Evropian. "Vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt BE-së ne do t'u qëndrojmë përkrah. Ky është edhe një prioritet i Presidencës gjermane të Këshillit të Bashkimit Evropian, gjatë së cilës Gjermania ka marrë veçanërisht përgjegjësi! Në përpjekjet për pajtim në rajon, si dhe në kapërcimin e pasojave ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga kriza e Koronës, ne do të jemi përkrah rajonit. Njerëzit duhet ta ndiejnë atë që përbën solidaritetin evropian dhe atë që e bën të veçantë dhe të vlefshme Evropën tonë të bashkuar", ka shkruar ai.

Gjermania, sipas tij, do t'i japë frymë të re dialogut, derisa ka folur edhe për idenë e shkëmbimit të territoreve, së cilës i është referuar si "ujdi e rrezikshme".



Maqedonia e Veriut kërkon test të Covidit për personat që kalojnë kufirin



PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka miratuar vendimin, sipas të cilit, shtetasit e Kosovës, Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjës, nga dita e enjte, gjatë hyrjes në këtë shtet, duhet të kenë testin e koronavirusit jo më të vjetër se 72 orë.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se vendimi i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut

për të kërkuar test të Covid-19 për personat që kalojnë kufirin vështirëson qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave mes dy shteteve. "Përmes ambasadorit të Kosovës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Gjergj Dedaj, kam shprehur shqetësimin për këtë veprim të nxituar dhe kam kërkuar që të evitohen barrierat e vlerësimit

dhe angazhimit dypalësh të situatës epidemiologjike dhe lëvizjes së lirë. I kërkoja ambasadorit që të adresojë tek organet kompetente nevojën e bashkëpunimit ndërshtetëror me qëllim të tejkalimit të pandemisë dhe koordinimit të përbashkët në luftën kundër virusit Korona", ka thënë Zemaj në reagimin e tij për media.

Veteranët e ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë protestuar në të gjitha qytetet e Kosovës për t'i kundërshtuar akuzat e ngritura për krime lufte ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli

Veteranët e UÇK-së kundërshtojnë Specialet

Me maska dhe duke respektuar distancën fizike, veteranët e ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë kundërshtuar pretendimet e Gjykatës Speciale për ish-luftëtarët e UÇK-së. Me moton "Në mbrojtje të luftës çlirimtare" me nga 99 persona, protesta është mbajtur në të gjitha komunat e Kosovës. Ata e kanë vlerësuar të padrejtë publikimin e propozimaktakuzës për presidentin Hashim Thaçi dhe liderin e PDK-së, Kadri Veseli. Sipas tyre, aktakuza është politike dhe goditje për shtetin e Kosovës



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 KORRIK - Veteranët e ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të enjten kanë protestuar në të gjitha qytetet e Kosovës për t'i kundërshtuar akuzat e Gjykatës Speciale ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli. Për shkak të pandemisë, veteranët protestën e kanë mbajtur në të gjitha komunat e Kosovës me nga 99 protestues, në mënyrë për t'i respektuar rregullat e distancës fizike.

Në protestën me moton "Në mbrojtje të luftës çlirimtare",

veteranët kanë vlerësuar se akuzat e Speciales janë politike sepse janë bërë me ndihmën e Serbisë.

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati, i ka quajtur akuzat ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së të padrejta dhe të njëanshme. "Jemi mbledhur anekënd Kosovës, në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme, për t'i kundërshtuar akuzat e padrejta dhe të njëanshme, të ndikuara politikisht nga një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare që po i bëhen UÇK-së tash e 20 vjet të orkestruara edhe nga Serbia dhe nga aleatët e saj", ka deklaruar ai.

Gucati ka vlerësuar se shpëlarja e këtyre akuzave është goditje për shtetin e Kosovës. "Shpallja e pazakontë e aktakuzave ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e befaso botën qytetare, pa i përjashtuar as ish-zyrtarët e lartë të Bashkimit Evropian, ushtarakë e njerëz më të ndikim politik botëror. Kurse popullin liridashës të Kosovës, i cili luftoi kundër makinerisë vrasare të Millosheviqit, i ndihmuar edhe nga aleatët ndërkombëtarë, e zhgënjyen thellë, sepse ata që

na kanë mësuar që 20 vjet për sundimin e ligjit dhe për zbatimin e sundimit të ligjit, po i shkelin vetë këto ligje në formën se si ata i ngritën këto akuzat, duke ndërhyrë në drejtësi, duke u dhënë këtyre gjykatave karakter politik", ka thënë Gucati.

Ai ka bërë me dije se koha e ngritjes së këtyre akuzave tregon për karakterin e tyre politik. "Si pasojë e veprimeve të kësaj gjykate u anulua takimi i 27 qershorit në Uashington që ishte paraparë për të filluar dhe për të mbaruar dialogu në mes të krerëve të shtetit të Kosovës dhe atij të Serbisë", është shprehur ai.

Kundër Gjykatës Speciale ka folur edhe përfaqësuesi i ish të burgosurve politikë, Meriman Braha. Ai ka thënë se do të duhej që kjo gjykatë t'i përfshinte të gjitha krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. "Jemi mbledhur sot këtu për ta ngritur zërin e protestës kundër veprimit selektiv, të njëanshëm e tendencioz të Gjykatës Speciale, formalo-juridikisht e quajtur e Kosovës e, në fakt, 'pjellë' e Serbisë dhe sponsorëve të saj të fuqishëm që tentojnë ta barazojnë xhelatin me viktimën", ka thënë

ai. Sipas tij, bashkësia ndërkombëtare duhet t'i ndjekë kriminelët serbë që kanë bërë krime në ish-Jugosllavi. "Ky është një shërbim i paprecedent që i bëhet një shteti që do të duhej të ishte i dënues për gjenocid në Kroaci, Bosnje dhe Kosovë. I drejtohem bashkësisë ndërkombëtare me kërkesën që t'i ndjekë seriozisht mekanizmat e drejtësisë që kanë bërë kriminelët e luftës në Kosovë, të cilët kanë qenë dhe akoma janë në pozita të larta shtetërore në Serbi", ka thënë Braha.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se të hënën do të udhëtojë për në Hagë për t'u intervistuar nga kjo gjykatë. Ai i ka ftuar ish-bashkëluftëtarët e tij që të bashkohen t'i përballon sfidat me të cilat po përballon vendi. "Uniteti qytetar, bashkëjetesa ndëretnike, stabiliteti institucional dhe besimi në institucione janë të domosdoshme që Kosova ta jetësojë vizionin që të jetë pjesë e NATO-s, Bashkimit Evropian dhe ta ruajë miqësinë e përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka vlerësuar Thaçi.



Ministrja Dumoshi takon anëtarët e Këshillit të Librit

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka prituri të enjten në takim anëtarët e sapoemëruar të Këshillit të Librit. Ministrja Dumoshi ka theksuar se qasja dhe bashkëpunimi i saj si ministre do të jetë gjithmonë në funksion dhe në ndihmë të autorëve dhe botuesve në Kosovë.

Libri dhe veprimtaria botuese është ndikuar dhe dëmtuar nga

pandemia Covid-19, prandaj edhe do të jenë pjesë e pakos emergjente për kulturë.

Ministrja u zotua se do të rritet fondi për përkrahjen e botimeve dhe blerje të librave si dhe u shpreh e bindur se Këshilli do të jetë aktiv në angazhimet e veta dhe do të punojë me profesionalizmin e duhur, në atë mënyrë që të bëhet seleksionimi i duhur i autorëve dhe librave që do të përkrahen nga MKRS-ja.

Gjithashtu, theksoi se prioritet i saj për këtë mandat është themelimi i Qendrës së Librit.

Edhe anëtarët e sapoemëruar u zotuan se do të angazhohen maksimalisht brenda funksionit dhe detyrës që u është dhënë, ndonëse viti 2020 dhe situata me Covid-19 ka bërë që aktiviteti i botuesve të bjerë ndjeshëm dhe kjo ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në prurjet e reja të autorëve.

Këshilli i Librit, bazuar në ligjin për librin dhe veprimtarinë botuese, emërohet nga ministri i Kulturës dhe është organ këshillëdhënës, që ka për qëllim të japë iniciativë dhe të propozojë vendime në të mirë të veprimtarisë botuese, të librit dhe të leximit të tij.

Këshilli i Librit përbëhet nga një përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së

Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Universitetit të Prishtinës, Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Shoqatës së Botuesve të Kosovës, Institutit Albanologjik si dhe nga krijues të afirmuar (sipas gjinive letrare: një poet, një prozator, një kritik letrar).



KUVENDI I KOSOVËS PA KONSENSUS PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

PËR HERË TË TRETË KUVENDI DËSHTON PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur as për herë të tretë t'i ratifikojë pesë marrëveshje ndërkombëtare. Ratifikimin e këtyre marrëveshjeve nuk e kanë mundësuar as votat e PDK-së. Lëvizja Vetëvendosje nuk ka përkrahur këto marrëveshje, ndërsa disa deputetë të pozitës nuk kanë marrë pjesë në votim për shkak të infektimit me Covid-19. Kjo ka bërë që të shqyrtohet mundësia e ndryshimit të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës në mënyrë që të mundësohet votimi në distancë. Sipas qeverisë, pa ratifikimin e këtyre marrëveshjeve është i pamundur zbatimi i pakos fiskale emergjente

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kuvendi i Kosovës ka dështuar sërish që t'i ratifikojë disa marrëveshje ndërkombëtare financiare për shkak të mungesës së kuorumit. Pesë marrëveshjet me vlerë qindra miliona euro kanë marrë vetëm 75 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Por, për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është e nevojshme mbështetja e 2/3 të deputetëve të Kuvendit apo 80 vota. Ministria e Financave ka

treguar se pesë marrëveshjet ndërkombëtare janë në vlerë prej 253 milionë eurosh dhe do ta ndihmonin Kosovën për përballimin e situatës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se për këto marrëveshje do të votohet një ditë tjetër. Madje ajo ka përmendur edhe ndryshimet në Rregulloren e Punës së Kuvendit, ku përmes miratimit të një amendamenti do t'u lejohej që deputetët të votonin online.

Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka mbështetur idenë e kryeparlamentares Osmani. Pas seancës, në profilin e vet në "Facebook", ajo ka shkruar se është koha ta ndryshojnë Rregulloren e Kuvendit që të votohet rishikimi i buxhetit dhe marrëveshjet ndërkombëtare. "Sot në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk kaluan marrëveshjet ndërkombëtare për financim të disa projekteve në shumë monetare prej 62 milionë eurosh. Është tepër me rëndësi që sa më parë të ndryshohet Rregullorja e

Kuvendit të Republikës së Kosovës në mënyrë që të mundësohet votimi në distancë. Sot shumë deputetë nuk ishin të pranishëm për shkak të pandemisë, pasi një pjesë e tyre edhe janë prekur me Covid-19. Në këtë situatë të krizës, të ballafaqimit me pandeminë, rishikimi i buxhetit është jetik për republikën tonë", ka shkruar Bajrami.

Ajo ka treguar se votimi i këtyre marrëveshjeve është jetike për rimëkëmbjen ekonomike. "Votimi i të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare, sidomos atyre për huamarrje është jetik, për shkak se krijohen mundësi për rimëkëmbje ekonomike dhe përballim të situatës me Covid-19. Secili prej nesh kemi obligim ndaj bizneseve dhe ndaj qytetarëve që këto marrëveshje të votohen, sepse nga taksat e qytetarëve e të bizneseve paguhen ministrat e qeverisë, deputetët dhe mbi 80 mijë zyrtarë publikë", ka shkruar ajo, duke u bërë thirrje deputetëve që sa më shpejt ta

votojnë ndryshimin e rregullores. "Të nderuar deputetë, ju ftoj që ta ndryshoni sa më shpejt Rregulloren e Kuvendit dhe të votohet rishikimi i buxhetit. Të votohen marrëveshjet ndërkombëtare dhe të ecim tutje. Vota për rishikimin e buxhetit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare është votë për qytetarët e vendit tonë", ka shkruar Bajrami.

Shef i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, ka treguar se ky subjekt politik është shprehur i gatshëm që ta japë votën për marrëveshjet ndërkombëtare, duke e ftuar qeverinë që të ndërtojë ura bashkëpunimi dhe komunikimi me opozitën. "PDK-ja asnjëherë nuk ka qenë kundër këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare. Qeveria e ka kuptuar se duhet të ndërtojë ura të bashkëpunimit, komunikimit dhe nuk duhet të thotë se ne si parti opozitare duhet të pajtohemi për gjithçka dhe çdo temë me qeverinë, por për tema të rëndësishme duhet ta gjejmë rrugën e komunikimit



Apostolova: Jam thellësisht e zhgënjyer nga deputetët që nuk ratifikuan marrëveshjet ndërkombëtare

Shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë se është thellësisht e zhgënjyer që sot në Kuvendin e Kosovës nuk kaluan marrëveshjet ndërkombëtare. Ajo ka thënë se mosmarrëveshjet

përfaqësuesve të partive politike në Kosovë po e privojnë popullin nga përfitimi i fondeve ndërkombëtare dhe atyre të BE-së. "Thellësisht e zhgënjyer nga deputetët që nuk arritën t'i ratifikojnë sërish marrëveshjet ndërkombëtare

sot. Mosmarrëveshjet politike të përfaqësuesve të popullit të Kosovës po u pamundësojnë qytetarëve të përfitojnë nga përkrahja ndërkombëtare dhe fondet e BE-së", ka shkruar ajo në llogarinë e vet në "Twitter".



"Facebook".

Ndërsa analisti tjetër Agron Demi ka thënë se ky sistem qeverisës është i kalbur. Sipas tij, kjo qeveri mund t'i sigurojë vetëm pagat e veta, por jo edhe 170 eurot për qytetarët. "Për të votuar në distancë, nevojitet amendamenti i Rregullores së Punës së Kuvendit, e që nuk mund të bëhet ngaqë nuk janë 80 vota për të votuar. Buxheti nuk po mund të rishikohet në mungesë të votave, kështu shumë qytetarë nuk do të mund t'i marrin nga 170 euro, e ata që bllokohen ligjet në Kuvend e Qeveri vazhdojnë t'i marrin nga 2 000 euro në muaj. Qytetarët dhe rreth 100 mijë biznese që paguajnë taksa, penalizohen nga zyrtarët që paguhen nga këto taksa", ka shkruar Demi në profilin e vet në "Facebook".

Qeveria e Kosovës nuk e mbështetë nismën ligjore për luftimin e pandemisë

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 KORRIK - E drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar të enjten mbledhjen e dymbëdhjetë të rregullt, në të cilën ka miratuar vendime dhe dokumente të tjera të fushave të përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese.

Në këtë mbledhje Qeveria e Kosovës ka shqyrtuar kërkesën e Kuvendit të Kosovës për dhënien e mendimit lidhur me nismën legjislative të grupit të deputetëve për Projektligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës.

Të gjitha ministrat kompetentë e kanë përcjellë opinionin dhe deklaratat e tyre sipas fushëveprimit përkatës të tyre, në rrjedhë të kësaj Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se nuk e mbështetë nismën legjislative të iniciuar nga disa deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për rregullim të ri ligjor me të cilën bëhet kufizimi i disa prej lirive dhe të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Qeveria e ka vlerësuar të panevojshëm miratimin e projektligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës me arsyetimin se ligjet e aplikueshme në Kosovë e rregullojnë në mënyrë të mjaftueshme fushën e luftimit dhe të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë. Konsideron se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka dispozita të veçanta që adresojnë çështje që institucionet e Kosovës kanë për obligim t'i ndërmarrin në raste të caktuara të rrezikut të shëndetit publik.

Nisma që Kosova të ketë një ligj për luftimin e pandemisë ka qenë e kryetares së Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani. Ky projektligj për pandeminë është i bazuar në nenin 65, pika 1, e Kushtetutës së Kosovës, që ua lejon deputetëve iniciimin e nis-

mave legjislative. Sipas Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Qeveria e Kosovës kishte afat që deri në fund të kësaj jave ta japë opinionin për nismën e Osmanit.

Qeveria ka shqyrtuar edhe kërkesën tjetër të Kuvendit të Republikës së Kosovës për dhënien të mendimit lidhur me nismën legjislative për Projektligjin për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e Pandemisë Covid-19. Sipas procedurave përkatëse, të gjitha ministrat kompetentë kanë përcjellë opinionet dhe deklaratat e tyre sipas fushëveprimit përkatës të tyre. Në rrjedhë të kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se tashmë ka ndërmarrë veprimet konkrete për adresimin e çështjeve të ngritura në nismën legjislative. Tashmë ka proceduar në Kuvend Projektligjin për rishikimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, ku ka planifikuar mobilizimin e një buxheti në vlerë prej 385 milionë eurosh për zbatimin e planit për rimëkëmbje ekonomike.

Gjithashtu, Ministria e Financave me procedura urgjente është duke e draftuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike pas pandemisë Covid-19, i cili projektligj është paraparë edhe në programin legjislativ të qeverisë për vitin 2020. Qeveria vlerëson se çështjet të cilat synon t'i adresojë nisma e tillë legjislative

do të përfshihen në kuadër të Projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike pas pandemisë Covid-19, i cili shumë shpejt do të finalizohet nga Ministria e Financave dhe pas miratimit në qeveri do t'i procedohet Kuvendit për aprovim.

Në funksion të avancimit dhe rregullimit të planifikimit strategjik, Qeveria e Kosovës ka themeluar strukturat për planifikim strategjik, respektivisht Komisionin për Planifikim Strategjik dhe Grupin Drejtues për Planifikim Strategjik. Komisioni për Planifikim Strategjik është mekanizëm që do ta drejtojë procesin e Kornizës Kombëtare të Planifikimit dhe Menaxhimit Strategjik në Kosovë. Anëtarët e përhershëm të KPS-së janë: Kryeministri, kryesues; Zëvendëskryeministri, zëvendëskryesues; Ministri i Financave; kryesues i GDPS-së. Ndërsa Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik është mekanizëm koordinues ndërinstitucional që mbështet Komisionin dhe është përgjegjës për koordinimin e zhvillimit të dokumenteve kryesore strategjike, sigurimin e harmonizimit të dokumenteve strategjike dhe ndërlidhjes me burimet buxhetore, koordinimin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar në Kosovë si dhe sigurimin e koordinimit dhe harmonizimit të proceseve kryesore planifikuese të qeverisë.



dhe duhet të ketë bashkëpunim me opozitën që çështjet e rëndësishme të kalojnë në këtë Kuvend. Vota e PDK-së do të jetë në përkrahje të marrëveshjeve", ka deklaruar Hamza.

Ndërsa subjekti më i madh opozitar, Lëvizja Vetëvendosje, është shprehur kundër këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare.

Analistët kritikojnë Kuvendin për mosratifikim të marrëveshjeve

Njohësit e rrethanave politike në vend e kanë kritikuar mosratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat do t'i sillnin vendit qindra miliona euro. Për këtë veprim disa analistë kanë kritikuar pozitën e disa opozitës.

Analisti Blerim Latifi ka kritikuar votën e LV-së kundër këtyre marrëveshjeve, duke thënë se këtij subjekti politik i intereson vetëm pushteti. "Sot në Kuvendin e Kosovës do të duhej të votoheshin disa marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare, krejtësisht të karakterit ekonomik, por miratimi i tyre dështoj sepse Vetëvendosja votoi kundër. Do të thotë, Vetëvendosjes më shumë i intereson revanshi partiak se interesi publik i vendit! Dhe derisa vazhdon të pretendojë se përfaqëson moralin në politikën e Kosovës, në fakt po na dëshmon se është, thjesht, demagoge, që nuk po ia del dot ta frenojë shprehjen e egoizmit partiak", ka shkruar Latifi në profilin e vet në

KËTO JANË MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE QË NUK JANË MIRATUAR

Kuvendi i Kosovës ka dështuar t'i ratifikojë këto marrëveshje ndërkombëtare: Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar; Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan; Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim; Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Dogana 2020"; dhe Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit "Fiskalis 2020".

Zyra e OKB-së në Kosovë ndihmon Malishevën me mjete mbrojtëse anti Covid-19

MALISHEVË, 9 KORRIK (ER) - Zyra e Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka përkrahur Komunën e Malishevës, me një donacion me maska dhe doreza, në kuadër të përkrahjes për komunat e Kosovës. Kohë më parë UNMIK-u e ka përkrahur Komunën e Malishevës edhe me pako ushqimore për familjet në nevojë.

Për këtë donacion të enjten kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, gjatë pritjes në zyrën e tij për zyrtarët

e UNMIK-ut, Lino Sciarra dhe Abedin Lataj, i ka falënderuar për këtë ndihmë si dhe për ndihmën e mëhershme për Komunën e Malishevës.

Ndërsa zyrtari Sciarra tha se "i vjen mirë që kanë mundësi t'i ndihmojnë komunat në Kosovë me mjete mbrojtëse, me qëllim edhe të solidarizimit në luftën e përbashkët kundër Covid-19 dhe këtë e konsiderojnë një ndihmë direkte për komunat". Begaj e Sciarra kanë biseduar për situatën e përgjithshme me Covid-19 në Malishevë.



Në mjediset me shumicë serbe në Kosovë, 258 të infektuar me Covid-19

PRISHTINË, 9 KORRIK - Që nga fillimi i pandemisë, në mjediset me shumicë serbe në Kosovë janë regjistruar 258 persona me Covid-19. Nga ky virus në këto vendbanime me shumicë serbe kanë vdekur 10 persona. Vetëm në dy ditët e fundit janë testuar 123 persona dhe prej tyre 96 kanë dalë pozitiv në

koronavirus.

Të dhënat janë siguruar nga Instituti i Shëndetit Publik në Mitrovicën e Veriut, i cili funksionon në kuadër të sistemit shëndetësor të Serbisë. Vetëm në tri javët e fundit numri i përgjithshëm i të infektuarve ka arritur në 139.

Nga ky numër, 122 janë nga

komunat në veri të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, ndërsa 17 janë nga zonat e tjera të banuara me serbë në Kosovë. Para kësaj periudhe, këto lokalitete për 20 ditë rresht nuk kishin shënuar asnjë rast me coronavirus, përkatësisht nga 29 maji deri më 18 qershor.

Që nga data 12 mars, sipas të dhënave, janë testuar 2 252 persona.

Në katër komunat veriore, numri i përgjithshëm i të infektuarve është 237, ndërkaq në mjediset e tjera të banuara me serbë në Kosovë janë 21 të infektuar.

Në raportet zyrtare të Institutit

Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShPK) të Kosovës nuk përfshihen në baza ditore të dhënat nga mjediset e banuara me shumicë serbe, megjithëse Ministria e Shëndetësisë e Kosovës i tha Radios Evropa e Lirë se pranon raporte nga komunat me shumicë serbe.

Për shembull, më 8 korrik, 214 raste të reja të koronavirusit u regjistruan në Kosovë, nga 413 të testuar. Në raport nuk u publikuan të dhënat nga mjediset e banuara me shumicë serbe. Në këto mjedisje janë raportuar 96 raste të reja në ditët e fundit.

Epidemiologu i Institutit të Shëndetit Publik në Mitrovicën e Veriut, Aleksandar Antonijević, i tha Radios Evropa e Lirë se të dhënat për pacientët në zonat serbe janë përfshirë në një bazë të dhënash në nivel të shtetit të Serbisë.

Sipas raportit të IKShPK-së të publikuar të mërkurën, numri i përgjithshëm i të infektuarve me coronavirus në Kosovë ka arritur në 4 100. Prej tyre, 86 persona kanë vdekur nga sëmundja Covid-19, ndërsa 2 063 janë shëruar.



Mbahet mbledhje komemorative në nderim të jetës dhe veprës së Sabahajdin Qeskës

RAHOVEC, 9 KORRIK (ER) - Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në përkujtim të jetës dhe veprës tani më të ndjerit Sabahajdin Qeska, (inspektor për çështje komunale), Komuna e Rahovecit ka organizuar mbledhje përkujtimore. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin kryetari i komunës, Smajl Latifi, nënkryetari Fatmir Iska, kryesuesi i Kuvendit, Afrim

Dina, familjarë dhe bashkëpunëtorë të të ndjerit.

Në fjalimin e tij, kryetari Smajl Latifi ka thënë se Sabahajdin Qeska tash e 17 vjet shërbeu me përkushtim dhe devotshmëri si inspektor për çështje komunale, ku dha kontributin e tij të pashoq, profesionalizmin dhe punën e tij që do ta mbajnë përherë të paharrueshëm për familjen, kolektivin dhe rrethin shoqëror që ai kishte.



Liderët politikë nga Lugina kërkojnë përfshirjen në bisedimet Kosovë - Serbi

Kryetari i Komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi, gjatë takimit që ka pasur me ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi, dhe me ministren për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Meliza Haradinaj-Stublla, të cilët po qëndrojnë për një vizitë zyrtare në Luginë, ka thënë se Lugina duhet të përfshihet në procesin e dialogut Kosovë - Serbi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRESHEVË, 9 KORRIK - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, së bashku me ministren për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Meliza Haradinaj - Stublla, po qëndrojnë në një vizitë zyrtare në Luginë të Preshevës. Ministri Selimi dhe ministrja Haradinaj - Stublla, me të arritur në Luginë, janë pritur nga kryetari i Komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi. Me kryetarin Arifi, ministrat kanë diskutuar për gjendjen e shqiptarëve në Luginë si dhe për mundësitë e mbështetjes së tyre. Në takim dy ministrat u informuan me situatën aktuale politike në Preshevë, pozitën dhe kërkesat e qytetarëve shqiptarë dhe projektet e komunës të cilat janë në interes dhe në shërbim të përmirësimit të jetesës së qytetarëve në vend. Gjithashtu, u theksua rëndësia e angazhimit dhe punës së përbashkët me qëllim të forcimit të faktorit shqiptar atje.

U ritheksua kërkesa e kryetarit Arifi për të qenë pjesë e takimeve të dy qeverive shqiptare për t'i sinkronizuar politikat e përbashkëta, veçanërisht në rastin e përfshirjes së Luginës në

procesin e dialogut, pasi që një marrëveshje e arritur pa e përfshirë Luginën e Preshevës, sipas kryetarit Arifi, do të ishte e paqëndrueshme.

Ministri Selimi në këtë takim ka potencuar faktin se rikthimi në Preshevë i jep atij një ndjesi tejet të veçantë, por edhe një përgjegjësi ndaj atij vendi. Duke folur për pozitën e qytetarëve të Preshevës, potencialin e lartë që ka dhe problematikat me të cilat ballafaqohet, ministri Selimi ka thënë se së bashku me ministren Haradinaj mbeten të përkushtuar për të ndihmuar dhe ofruar bashkëpunim të pakursyer për të bërë më të mirën për shqiptarët në këtë anë. "Si ministër i Drejtësisë, në emrin tim dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës ju siguroj se do të vazhdojmë të kemi një qasje të përkushtuar dhe një bashkëpunim të vazhdueshëm si në aspektin politik, ekonomik dhe kulturor për të përmirësuar dhe avancuar pozitën e shqiptarëve të Luginës në përgjithësi. Komuna e Preshevës do ta ketë gjithë mbështetjen tonë për realizimin e projekteve konkrete për Luginën", ka thënë Selimi.

Kryetari Arifi, po ashtu, u sigurua

nga ministri Selimi se do të ketë mbështetjen e ministrisë të cilën ai e drejton për kthimin e Gjykatës dhe Prokurorisë në Preshevë dhe për këtë ofroi mbështetje financiare dhe profesionale për t'i kthyer këto degë në vendin që iu takon.

Ministri Selimi u shpreh i gatshëm për t'i shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe urat e ndërtuara nga dy vendet për ta shtuar bashkëpunimin dhe koordinimin në interes të qytetarëve të Luginës. Pjesë e këtij delegacioni ishte edhe drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikanë, Arian Zeka, pjesë e së cilës Odë janë shumë biznese nga Presheva.

Zhvillimi i sektorit privat, i domosdoshëm për përmirësimin e jetës së qytetarëve shqiptarë në Luginë

Në vazhden e takimeve të cilat po i zhvillon ministri Selimi së bashku me ministren Haradinaj-Stublla, të enjten janë pritur edhe nga përfaqësuesit e sektorit privat në Preshevë nga të cilët ka dëgjuar sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen bizneset e tyre si dhe klimën e pafavorshme të të bërit biznes në këtë rajon. Duke marrë parasysh situatën e krijuar dhe dëmet që ka shkaktuar te çdo biznes përballja me pandeminë Covid-19, njëherësh duke i ditur edhe vështirësitë me të cilat përballet ekonomia në Preshevë, Ministri Selimi u shpreh i gatshëm për të diskutuar rreth projekteve konkrete të përbashkëta me synim të rimëkëmbjes së bizneseve, zhvillimit ekonomik të vendit si dhe rritjen e punësimit të qytetarëve të Preshevës. Sipas ministrit Selimi, zhvillimi ekonomik përbën një rëndësi të posaçme për përmirësimin e jetës së bashkëkombësve tanë dhe për këtë duhet të shihet si prioritet me rëndësi, sidomos sektori privat. Lugina e Preshevës ka potencial të konsiderueshëm për zhvillim qoftë nga aspekti gjeografik, natyror dhe njerëzor, dhe këto resurse duhet të shfrytëzohen. "Përveç pjesës politike me të

cilën diskutuam me kryetarin Arifi, ne e kemi parë të rëndësishme që t'i vizitojmë bizneset e mëdha këtu në Preshevë, siç janë kompania 'Fluid', 'Solid' dhe 'Weslime', tri kompani të suksesshme të cilat e kanë potencialin, talentin dhe vullnetin e madh për punë, me prodhimet e të cilave do ta mbulonin jo vetëm tregun e Serbisë, por edhe rajonin dhe botën. Presheva është lënë mbrapa nga Republika e Serbisë, por assesi nuk ka mbetur mbrapa me shtrirjen e saj ekonomike, arsimore dhe politike. Republika e Kosovës do t'u qëndrojë në krahë këtyre bizneseve për mirëfunksionimin dhe shtrirjen sa më të gjerë të produkteve të tyre". Kjo vizitë u prit me optimizëm nga përfaqësuesit e sektorit privat të cilët kanë falënderuar ministrin Selimi për angazhimin dhe përkushtimin e tij për trajtimin e kësaj problematike dhe për ofrimin e ndihmës në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kryetari Arifi ka falënderuar dy ministrat për interesimin e vazhdueshëm dhe përkrahjen e ofruar nga institucionet e Republikës së Kosovës duke e vlerësuar shumë të rëndësishme për stabilitetin dhe përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në Preshevë.



Bajrami: Implementimi i plotë i pakos emergjente bëhet pasi të kalojë rishikimi i buxhetit

**EPOKA E RE****A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka thënë se kanë shkuar shumë vërejtje në adresë të këtij institucioni për mosimplementim të masave të pakos emergjente. Sipas saj, pa rishikim të buxhetit nuk mund të ketë ekzekutim të pagesave. “Kanë ardhur shumë vërejtje në adresë të Ministrisë së Financave për mosimplementim të masave të

pakos emergjente. Dua t’ju bëj me dije disa gjëra. E para, sipas rregullores së re të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Financave është përgjegjëse për sigurimin e buxhetit për implementim të plotë të pakos emergjente dhe ekzekutim të pagesave përmes Thesarit sipas kërkesave që bëjnë ministrinë e linjës. Më lejoni t’ju njoftoj se Ministria e Financave ka gjetur burime financiare për implementim të të gjitha masave të pakos paraprake dhe për masat e reja

për rimëkëmbje ekonomike, por këto mjete financiare mund të shpenzohen vetëm pasi të kalojë rishikimi i buxhetit”, ka shkruar Bajrami në logarinë e saj në “Facebook”.

Ajo ka listuar edhe përgjegjësitë institucionale deri në ekzekutimin e këtyre pagesave. “E dyta, sipas rregullores së re të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Financave nuk është përgjegjëse për aprovim të aplikacioneve/kërkesave. Për aprovim të aplikacioneve për të

gjitha masat që kanë të bëjnë me masat për sektorin privat është komisioni ndërinstitucional, i cili e ka përfunduar punën e vet plotësisht, është përgjegjëse Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për aprovim final të listave. Te Ministria e Financave thjesht vjen kërkesa për ekzekutim e cila Thesarit i merr vetëm disa orë për ekzekutim”, ka thënë Bajrami, duke shtuar se për masën numër 15 përgjegjëse janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

dhe Ministria e Financave vetëm ekzekuton pagesat. “Kështu, për momentin, implementimi i masave është peng i votimit të rishikimit të Ligjit të Buxhetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndërsa në momentin kur kalon rishikimi i buxhetit në Kuvend, përgjegjësia është te Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për masat në mbështetje të sektorit privat dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për masën numër 15”, ka thënë ministria Bajrami.

Ulet norma e akcizës për lëngjet dhe veturat hibride

EPOKA E RE**Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka aprovuar ndryshimin e akcizës për veturat hibride për të cilat do të paguhet vetëm 10 euro kur ato hyjnë në Kosovë për dallim që më herët shuma ishte 500 euro.

Propozimi është votuar në qeveri dhe pritet të hyjë në fuqi porsa të njoftohet Komisioni për Buxhet dhe Financa. “Ministria e Financave propozon uljen e normave tatimore të veturave hibride (me shifër 870340, 8735000, 87360 dhe 8703700) nga 500 euro në veturë, në 10 euro për veturë. Një pjesë e këtyre veturave zaten janë të liruara nga çdo lloj tatimi doganor, por disa kode vazhdojnë të jenë të ngarkuara.



Andaj, me qëllim të uljes së barrierave të blerjes së këtyre veturave që janë shumë më pak të dëmshme për ambientin, propozojmë këtë ndryshim. Ndikimi në të hyrat nga ky ndryshim është shumë i ulët, ku në katër vitet e fundit nga ky lloj tatimi janë arkëtuar vetëm 11 000 euro”, ka thënë Bajrami në

mbledhjen e qeverisë. Po ashtu, në mbledhje të qeverisë është marrë vendimi edhe për uljen e tatimit në akcizën e lëngjeve. Akciza është zvogëluar në gjysmë centi për litër. “Me qëllim të adresimit të kërkesave të pranuar nga sektorët përkatës, si Ministri e Financave kemi propozuar

ndryshim të politikave fiskale, konkretisht ulje të normës së tatimit të akcizës për lëngjet dhe për veturat hibride. Për njoftimin tuaj, lista fillestare e produkteve/mallrave që i nënshtrohen tatimit të akcizës është përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovës dhe ky ligj i ofron fleksibilitet Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshime të normave të akcizës. Ky vendim është bazuar në nenin 3, paragrafi 1 i këtij ligji. Sektori i lëngjeve një kohë të gjatë ka paraqitur kërkesa të vazhdueshme për lirim nga akciza për lëngjet e caktuar që përmbajnë sheqer (subjekt i shifrës 2202). Këto mallra aktualisht kanë normë të akcizës

në vlerë prej 0.045 (katër cent e gjysmë) një litër. Ministria e Financave ka shqyrtuar seriozisht këtë kërkesë dhe propozon që norma e akcizës të ulet nga kjo vlerë në 0.005 (gjysmë centi) për një litër. Kësisoj, po ashtu, kjo është edhe në përputhje me programin qeverisës 2020-2023, në pikat e mbështetjes së sektorit privat dhe të lehtësimit të barreve tatimore”, ka shtuar Bajrami. Klubi i Prodhuesve të Kosovës e ka përkrahur vendimin për uljen e normës së akcizës për lëngjet, duke theksuar se një gjë e tillë ndikon drejtpërdrejt në rritjen e konkurrueshmërisë së prodhuesve vendorë, e në veçanti të sektorit të lëngjeve dhe është një ndihmesë shumë e madhe, sidomos pas situatës së krijuar në sektorin e prodhimit pas pandemisë Covid-19.

Rukiqi, thirrje deputetëve: Sa më parë të adresohen kërkesat e sektorit privat

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka theksuar se Kuvendi i Kosovës dhe secili deputet duhet të jetë në funksion të rimëkëmbjes ekonomike. “Nevojat urgjente të bizneseve duhet të adresohen sa më parë dhe sektori privat u bënë thirrje pozitës dhe opozitës të jenë të unifikuara për përkrahjen e ekonomisë së vendit”, ka thënë Rukiqi

duhet të trajtohet si i tillë. “Mos të harrojmë se sektori privat është taksapaguesi dhe punëdhënësi më i madh. Ai, mes të tjerash, garanton mirëqenien e mijëra qytetarëve të vendit. Por, e vërteta e hidhur është se sot, si rezultat i pandemisë Covid-19 dhe mosveprimit të shpejtë institucional, bizneset e Kosovës po luftojnë për mbijetesë. Mbijetesa e bizneseve dhe zgjidhja e shumë problemeve tani nuk është e mundshme pa ndërhyrjen e shtetit e cila duhet të jetë me synime të qarta dhe efikase. Sektori privat pa kushte ka përkrahur vendin dhe institucionet shtetërore në çdo kohë dhe tani, duke njohur e ditur kapacitetin e kufizuar buxhetor, shpreson në përkrahjen e institucioneve përkatëse dhe gjetjen e modaliteteve për ta lehtësuar gjendjen”, është shprehur Rukiqi. Ai ka bërë thirrje që të implementohet në tërësi Pakoja Emergjente. “Për biznesin dhe punëtorët e sektorit privat, që janë taksapaguesit kryesorë në vend, ka pak rëndësi se kush duhet të marrë vendim, a duhet

rishikim buxheti apo jo dhe komplikimet e tjera ligjore dhe politike. Rrjedhimisht, konsiderojmë se rishikimi i buxhetit dhe marrëveshjet ndërkombëtare do të duhej të votoheshin sa më parë, pasi janë jetike për shpëtimin e ndërmarrjeve dhe vendeve të punës dhe si të tilla do të duhej të ishin mbi interesin partiak. Gjithashtu, pakoja e rimëkëmbjes ekonomike, mbetet shpresa dhe rrugëdalja e vetme nga një kolaps i mundshëm ekonomik, me pasoja të pariparueshme për dekada të tëra”, ka deklaruar ai. Rukiqi ka theksuar se Kuvendi i Kosovës dhe secili deputet duhet të jetë në funksion të rimëkëmbjes ekonomike. “Nevojat urgjente të bizneseve duhet të adresohen sa më parë dhe sektori privat i bënë thirrje pozitës dhe opozitës të jenë të unifikuara në përkrahjen e ekonomisë së vendit. Ju bëj apel ta konsideroni me seriozitet të lartë gjendjen e sektorit privat sepse një veprim i shpejtë institucional është i domosdoshëm për ta mundësuar

mbijetesën e ekonomisë sonë. Përdorimi të gjithë ne duhet t'i ndryshojmë sjelljet konform normalitetit të ri, gjithmonë duke synuar parandalimin e përhapjes së valëve të reja të Covid-19, është e rëndësishme të mobilizohemi të gjithë, sidomos Kuvendi dhe Qeveria, si aktorë kyçë, për përkrahje të bizneseve”, ka thënë Rukiqi, duke shtuar se janë duke punuar çdo ditë për vetëdijësim të bizneseve, duke vendosur theksin në respektim të mirëfilltë të masave të distancës sociale, mbajtje të maskave dhe higjienës nga punonjësit, dezinfektim të rregullta dhe siguri të produkteve si masa esenciale për mosrritjen e numrit të rasteve. “Kosova nuk e ka komoditetin të humbë asnjë vend pune. Kosova e as sektori privat nuk mund të mbeten në mëshirë të fatit e të kohës. Ne mbetemi të përkushtuar për t'i bashkërenduar aktivitetet dhe ofruar ndihmën e pakufizuar, në funksion të përkrahjes së ekonomisë të vendit. T'i shpëtojmë ndërmarrjet tona. Dora e shtetit në përkrahje të biznesit”, ka thënë kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi.

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, u është drejtuar të enjten me një letër publike deputetëve të Kuvendit të Kosovës që t'i lënë anash inatet politike dhe të bëhen bashkë për të mirën e qytetarëve të vendit. Ai ka thënë se ekonomia e Kosovës është dëmtuar rëndë nga Covid-19 dhe vendosja e masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së tij. “Tanimë është i njohur dëmi që i është shkaktuar sektorit privat e ekonomisë së vendit si pasojë e pandemisë, prandaj në këtë letër do të përpiqem të përqendrohem në

zgjidhjet e jo problemet që janë aq të shumta. Në cilësinë e kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, përfaqësues i zërit të më shumë se 15 000 bizneseve, ku ndër vite kemi avokuar për një ambient më të mirë të të bërit biznes, nxitje të investimeve e konkurrueshmërisë së bizneseve, është e vështirë dhe e dhimbshme të flas për një gjendje ku shumë biznese janë në prag të falimentimit, ku po humbasim mijëra vende pune dhe ku ekonomia e vendit është në gjendje tejet të rënduar”, ka thënë Rukiqi.

Ai ka thënë se sektori privat, padyshim, mbetet nxitësi më i fuqishëm i rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe



Punimet në autostradën 'Arbën Xhaferi' fillojnë të shtunën

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Ministria e Infrastrukturës ka njoftuar se nga dita e shtunë e deri në përfundim të punimeve do të ketë punime rrugore në autostradën “Arbën Xhaferi”, ndërmjet njëjës në pjesën Doganaj - Hani i Elezit. Përgjatë këtij segmenti rrugor, aktivitetet e punimeve në këtë pjesë të kësaj autostrade do të

zhvillohen në mirëmbajtjen e fugave të dilatimit të urave. Gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve, varësisht nga pjerrtësia tërthore e urave, do të bëhet mbyllja e përkohshme e njërit shirit qarkullues të trafikut në gjatësi sa nevojitet për zhvillimin e punimeve, duke vendosur shenja të përkohshme adekuate të

trafikut për paralajmërim të punimeve rrugore me ç'rast, pas përfundimit të punimeve, do të largohen menjëherë. Punimet do të kryhen në dy drejtimet, nyja Doganaj - Hani i Elezit dhe anasjelltas. Ministria e Infrastrukturës ka kërkuar mirëkuptimin e qytetarëve deri në përfundimin e këtyre punimeve.





© picture-alliance/dpa

KOSOVA KA HISTORI TË SHENJTËRUAR, ASGJË NUK E ZBEH ATË



Shkruan: Kudusi LAMA

Shqiptarët në gjithë jetën e tyre nën pushtimin serb e jugosllav janë ndeshur me pushtuesin pa ndërprerje për ta fituar lirinë. Nuk ishte lufta e fundit një fushatë. Ajo ishte lufta që u fitua. Ajo ishte lufta, krisma e së cilës u dëgjua në gjithë botën. Ishte ajo lufta ku u bë pjesëtare dhe mori lavdi e gjithë bota moderne.

Por ka edhe nga ata që nuk duan të dinë për sakrificat e shqiptarëve. Ka edhe nga ata që nuk dinë ose nuk duan të dinë nëse kanë luftuar ose jo shqiptarët për të drejtat e tyre. Ka edhe nga ata që për t'i shërbyer Serbisë përpiqen ta minimizojnë gjithë rrjedhën e zhvillimeve kombëtare shqiptare në Luftën Çlirimtare të Kosovës e më gjerë. Dick Marty ishte dhe është një prej atyre që, meqenëse pati

mundësi, i dha një ndihmë Serbisë, duke shpifur për shqiptarët.

Ka nga ata që kam dëgjuar të thonë, se ka korrupsion në Kosovë, prandaj mirë t'u bëhet. Unë nuk dua të pastroj korrupsionin. Unë dua të mos bëhet me baltë lufta e shenjtë çlirimtare. Ajo ka qenë vlera jonë. Atë vlerë, kur ishte e gjallë në terren, e njohën të gjithë anembanë botës. Ndërsa sot, pasi menduan se e vranë në njëfarë mënyrë, po tentojnë edhe ta përbaltin. Ne shqiptarët jemi tolerantë. Por askush nuk duhet të mendojë se na e ka vranë luftën çlirimtare të Kosovës. Askush nuk duhet të mendojë se na e ka vranë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ato janë gjallë dhe do të mbeten vlera të mëdha kombëtare në gjithë historinë shqiptare. Ani pse ka edhe ndonjë ndër shqiptarët që shprehet për UÇK-në - "ajo guerilja që ka bërë krime para 20 vjetëve" - keq për të.

Ajo luftë nuk u diktua, siç tentojnë ta etiketojnë disa. Ajo luftë diktoi realisht luftën e botës moderne kundër Serbisë. Idetë dhe konceptet lidhur me ardhmërinë e kombit tonë ne

nuk i ndërtojmë sipas laramanisë së zhvillimeve të të tjerëve, por sipas koncepteve të qëndrueshme të ardhmërisë së shqiptarëve e trojeve të tyre. Sprovat nëpër të cilat kemi kaluar janë treguesi më i qartë i qëndrësës sonë kombëtare. Vizioni ynë kombëtar dhe perspektiva e definuar bëjnë që shqiptarët të jenë në çdo kohë të atyndodhur për t'i mbajtur në dorë të gjitha linjat e rrugëtimit në shoqërinë e kombeve.

Historikisht kemi kërkuar paqen, qetësinë, stabilitetin dhe sigurinë, por gjithnjë duke ruajtur identitetin si një sfidë e cila ka qenë bashkudhëtare në përplasjet e mëdha me armiqtë që kanë tentuar të na zhbëjnë e të na grabisin trojet.

Në vazhdimësi, në momente kthesash të mëdha, ne jemi vlerësuar me nota të ulëta e në mjaft raste të dobëta. Na është thënë se nuk kemi krijuar dot institucione të qëndrueshme, se ato nuk arrijnë të prodhojnë stabilitet dhe siguri, se nuk po arrijmë të krijojmë demokracinë dhe mbisundimin e ligjit, se nuk po arrihen standardet e respektimit të të drejtave të

njeriut, sepse nuk po arrihen standardet e respektimit të të drejtave të minoriteteve, nuk po krijohet tregu i lirë dhe aftësia për ta mbijetuar konkurrencën e tregut, pastaj marrja përsipër dhe zbatimi i obligimeve dhe detyrave të dala nga kolegjaliteti evropian etj. Dhe, për çudi, të gjitha këto lindin në Beograd e Athinë dhe bëhen edhe deklarime të përkrahësve të tyre, duke krijuar kështu klane antishqiptare deri në politikën e madhe të Evropës.

Kjo më habit, për faktin se kur ishte në proces lufta për çlirimin e Kosovës, të gjithë ishin të mirë.

Flitej se shteti shqiptar ishte në nivel shumë të lartë, megjithëse në atë kohë realisht ai ishte shumë i dobët; Thuhej se Ushtria Çlirimtare ishte një forcë që po kryente një detyrë humane duke marrë në mbrojtje popullin shqiptar në Kosovë nga masakrat e shtetit fashist të Milosheviqit; Thuhej se populli shqiptar është një popull që meriton të vlerësohet me çmimin nobel për qëndrësën, unitetin dhe humanizmin; Thuhej se bashkëpunimi me UÇK-në

ishte shumë i frytshëm, prandaj sido që të ishte rezistenca serbe, nuk do të futeshin forca tokësore të NATO-s se ishte UÇK-ja në terren; Thuhej se delegacioni i shqiptarëve të Kosovës në Rambuje ishte në nivelin e bashkëpunimit të gjerë ndërkombëtar, kurse ai serb ishte në nivel tepër vulgar; Thuhej se Shqipëria ishte bërë një terren që prodhonte vetëm humanizëm për të shpërngulurit dhe që menaxhon në mënyrë tepër të lavdërueshme njerëzit në nevojë që regjimi fashist serb i kishte nxjerrë nga shtëpitë dhe pronat e tyre; Thuhej e çka nuk thuhej. Dhe nuk thuhej vetëm nga njerëz të nivelit të ultë, por thuhej nga presidenti Clinton, kryetari i OKB-se Kofi Anan, shefi politik i NATO-s, komandanti i NATO-s, kryetar të shteteve evropiane, gjeneralë, ministra, ambasadorë, delegacione, media etj.

Ndërsa sot thuhet monstruoze. Kjo është shumë interesante. Nga një komb që i duhej dhënë çmimi nobel për humanizëm, tash një popull kanibal që paska ngrënë

njerëz. Këto ndryshime nuk më duken të rastit. Më shkurt, kur ne ishim të fortë, se kishim në mal një ushtri prej 60 mijë luftëtarësh të zgjedhur, ishim të mirë. Se kishim një popull me vete, se kishim një komb të gatshëm për t'i rrëmbyer armët të cilat kishin përballë një shtet serb të ngarkuar mbi çdo masë me krime kundër njerëzve e popujve.

Por ajo kohë kaloi dhe, siç duket, kaluan edhe ato politika të vlerësimit të shqiptarëve, të cilët vërtet i merituan ato vlerësime. Por që segmente të politikës evropiane po tregojnë se paskan qenë vlerësime tregu, jo vlerësime bindjesh. Kjo na plagos vërtet ne shqiptarëve kur shikojmë se bëhen lojëra edhe me gjëra të tilla kaq serioze dhe bëhen nga ata që pretendojnë ta mbajnë në dorë timonin e anijes botërore në këtë det të trazuar të kohëve.

Dihet që Evropa ka plane të mëdha. Dhe unë jam plotësisht dakord që këto plane të zbatohen. Konkretisht ajo po tenton të bëhet një fuqi botërore, që të ketë kapacitete për t'u vënë përballë fuqive aktuale siç janë ShBA-ja, Kina, Oqeania etj. të cilat kanë sot tendencën për ta sunduar botën në konkurrencë me njëra-tjetrën. T'i krijosh kushtet për t'u ngjitur në një rang të tillë është lavdi. Evropa në këtë rrugë duhet ta ketë mbështetjen e të gjithë evropianëve, ndër ta edhe të shqiptarëve.

Por kur vjen puna tek uniteti, ai nuk mund të arrihet pa krijuar Evropa disa kushte, prej të cilave vlerësoi:

Së pari, pajtimin fetar, që më duket se nuk po e vlerëson si duhet. Nuk mund të ketë Evropë të bashkuar e të fuqishme pa vlerësim të ideve fetare të individëve. Ndërsa Evropa akoma vazhdon ta mbajë lart flamurin e Krishtit. Kjo nuk është politikë serioze dhe nuk ka perspektivë. Kurrë nuk mund të jetë Evropa unike dhe e fuqishme duke bërë diskriminim fetar. Ishte një nismë e shkëlqyer e Papa Gjon Palit të II-te (Vojtilës), për të afruar e pajtuar plotësisht besimet fetare, por që siç duket mbeti atje ku e la ai. Sot në Evropë ka jo vetëm myslimanë që duhen vlerësuar, por edhe budistë e të fesë izraelite që duhen respektuar. Pa këtë vlerësim, nuk mund të ketë unitet. Standardet me të cilat po vlerësohen Shqipëria, Kosova, Bosnje-Hercegovina dhe Maqedonia, më lënë shije të hidhur, sepse më kanë krijuar mendimin se nuk janë vlerësime për popuj evropianë, por vlerësime sikur të ishin popuj të ardhur dhe kjo më duket vetëm pre në këto vende dominojnë qytetarë të fesë islame.

Kam lexuar të thuhet se: "Bashkëjetesa si dhe e ardhmja e shoqërive nuk mund të kultivohet dhe zhvillohet duke thirrur në racizëm në emër të cilësdo fe". Ashtu sikurse: "Feja është institucion shpirtëror derisa nuk keqpërdoret, e kur keqpërdoret ajo më nuk është fe, por është anarki!"

Prej këtej unë vlerësoj se realisht po bëhet një punë e pa dobishme duke shfrytëzuar fenë për interesa politike e nacionale. Ne shqiptarët asnjëherë nuk jemi thirrur në emër të fesë, gjithnjë jemi thirrur në emër të atdheut e kombit, me synim lirinë dhe demokracinë. Por realisht sot po duket se feja në momente të ndryshme, nga segmente politike në shumë raste me ndikim po shfrytëzohet politikisht në Evropë dhe nacionalisht me theks të veçantë në Serbi e në Greqi.

Së dyti, vlerësimet kombëtare dhe etnike, kanë shumë rëndësi për një rritje të respektit të ndërsjellë. Unë jam shqiptar, deri dje Serbia më ka vrarë e zhdukur miliona njerëz, ndërsa sot në Evropë akuzohem unë se paskam vrarë disa serb në luftë, që edhe ata nuk dihet nëse janë të vërtetë, apo janë thjesht një pretendim serb. Ky është vërtet absurditet.

Së treti, vlerësimet publike për problemet kriminale, bëhen në mënyrë të tillë sikur shqiptarët paskan qenë shumë të fuqishëm. Kur dëgjoj që në krye të organizatave kriminale evropiane janë shqiptarët, në krye të organizatave të drogës janë shqiptarët, në krye të mafies janë shqiptarët, në krye të prostitucionit janë shqiptarët, në krye të trafikëve të paligjshme janë shqiptarët etj., ju them sinjerisht me vjen për të qeshur, sepse më duken vlerësime donkishoteske. Edhe po të duan shqiptarët, nuk mund të sundojnë për 20 vjet krimin që sundon Evropën prej 200 vjetësh. Këto janë shaka pa kripë.

Së katërti, vlerësimi i të drejtave të minoriteteve, bëhet me një diferencim të pa kuptueshëm. Për rreth 60 deri 80 mijë serbë në Kosovë apo për 30 mijë grekë në Shqipëri bëhet aq fjalë, sa duket sikur atyre nuk u është garantuar asgjë. Ndërsa për mbi 200 mijë shqiptarë në Serbi e mbi një milion shqiptarë në Greqi as që ngrihet zëri në Evropë, megjithëse serbët e grekët në Kosovë e Shqipëri janë kolonë, kurse shqiptarët në Serbi e Greqi janë autoktonë. Pse duhet të jetë ky tregues në Evropën demokratike? A ka perspektivë me mendësi të tilla?

Së pesti, në përgjithësi duken diferencime, si në procesin e zhvillimit e të fuqizimit ekonomik, politik, social, ushtarak e kulturor, ashtu edhe në vlerësimin e ideve për të

ardhmen. Unë pranoj diferencime kur është fjala për projektet e mëdha, të cilat duhet t'i përballojnë të fuqishmit. Por jo diferencime deri tek mënyra e të ngrënit të bukës, që nëse nuk e hamë bukën siç e hanë anglezët, gjermanët, francezët apo zviceranët, ne nuk qenkemi të zhvilluar. Këto për kohën tonë sipas mendimit tim janë vlerësime banale, që janë thjesht pretendime, për t'u gjendur një pretendim, jo për të balancuar vlerat.

Së gjashti, vlerësimi i drejtë i historisë, ka rëndësi të madhe sepse i zgjuar nuk është vetëm ai që ka fuqi e pasuri. Të zgjuar janë edhe ata që janë të varfër. Prandaj, kërkohet që sido të jetë, duhet të marrë secili vlerat historike që i takojnë. Jo të konsiderohen të drejta vetëm ato vlerësime që bëjnë të fuqishmit, qoftë edhe për të vendosur fate popujsh.

Së shtati, veshja e terrorizmit me uniformë islame më duket se nuk është një analizë serioze. Nuk është normale që të vishet me këtë uniformë çdo dështim në reformat perëndimore. Më duket se kjo çështje tashmë po

bie erë të keqe, ani pse nuk ka askush fuqi të vihet përballë këtyre analizave. Por veprime të tilla nuk do t'i bëjnë nder as Evropës që tenton të jetë fuqia më e madhe botërore, dhe që nëse do të korrigjojë politikën e saj, ta bëjë me gjithëpërfshirëse dhe me konkretë, për ta parë situatën më afër të vërtetës, me siguri që do të bëhet ajo që aspiron.

Së teti, diplomacia duhet të zhvishet prej rrobës së mashtrimit. Është e ditur që diplomacia është gjithnjë lojë interesash, por ajo do të jetë një lojë shumë e suksesshme, në qoftë se do të arrijë të vesh uniformën e fisnikërisë dhe në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, bashkëpunëtori të mundet prej fisnikërisë, jo prej trysnisë e prej mashtrimit, siç po duket se ndodhë në përgjithësi.


Së nënti, çdo vlerësim duke u mbështetur te vepra e Hangtingtonit, "Përplasja e Qytetërimeve", është një mashtrim i madh, pasi vetë kjo vepër është një mashtrim, sepse merr përgjegjësi që duket se nuk janë analizuar si dukuri shkencore, por janë analizuar

me porosi, sepse dikujt kështu i ka interesuar.

Së dhjeti, nëse nuk i shërbehet me kujdes rritjes së miqësisë, dashurisë dhe respektit të ndërsjellë midis njerëzve në Evropë, asnjëherë nuk kemi për të pasur një Evropë të bashkuar për së vërteti, dhe një Evropë që të sigurojë të ardhme fuqie botërore.

Se njëmbëdhjeti, edukimi i rinisë është në nivelet më të ulëta të mundshme. Duket se tentohet që me rininë të luhet, duke kërkuar të krijohen disa kulte individësh dhe një turmë e cila të jetë injorante dhe e bindur për të kryer ato detyra që i jepen. Një politikë e tillë nuk ka të ardhme. Injorantët janë të destinuar të bëhen ose skllëvër ose kriminelë.

Unë vlerësoj se ka edhe mjaft probleme të tjera të cilat vërtet janë ndikuese për një Evropë të fortë, por nuk po marr përgjegjësinë t'i jap direktiva Evropës. Mua më shqetëson vlerësimi për kombin të cilit i përkas, që nuk dua të jetë banal, dhe te të gjitha këto drejtime që përmenda më lart, kombi ynë ndien goditjen e segmenteve të politikës evropiane. (Vijon)




ShBA-ja dhe BE-ja po e përcjellin me vëmendje situatën në Serbi

BEOGRAD, 9 KORRIK - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Serbi ka thënë se i dënon të gjitha format e dhunës, përfshirë ato "që duket se janë sulme të koordinuara ndaj policisë", si dhe përdorimin e tepruar të forcës nga organet e sigurisë. ShBA-ja po ndjek me vëmendje ngjarjet e dy ditëve të fundit në Beograd dhe qytetet e tjera në Serbi dhe është thellësisht e shqetësuar me shfaqjen e dhunës, thuhet në deklaratën e Ambasadës Amerikane të publikuar në rrjetin social "Twitter". "Shqetësimet dhe debatet për atë se si një vend mund t'i shpëtojë njerëzit e tij nga pandemia më

vdekjeprurëse e kohës sonë - janë çështje serioze dhe duhet të jenë pjesë e një debati të qetë dhe të arsyeshëm në nivelin kombëtar", thuhet në reagimin e ambasadës.

Gjatë dy ditëve të fundit në Beograd dhe qytetet e tjera të Serbisë janë zhvilluar protesta të dhunshme, përmes të cilave po kundërshtohet mundësia e shtrëngimit të masave kundër pandemisë së koronavirusit.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, të martën paralajmëroi se mund të vendoset orë policore pas përkeqësimit të situatës epidemiologjike. Menjëherë, qindra njerëz dolën në rrugë për të protestuar. Por, më pas të



mërkurën ai tha, në një konferencë për media, se qeveria serbe mbase do të vendosë që të mos ketë orë policore.

Protestat Vuçiqi i quajti politike dhe se, sipas tij, ato nuk kanë lidhje me koronavirusin. Edhe Bashkimi Evropian ka thënë se po i ndjek me vëmendje

të madhe zhvillimet në Serbi. Ana Pisonero, zëdhënëse e BE-së, theksoi se u takon autoriteteve të secilit vend që të merren me vlerësimet e rrezikut të pandemisë. Ajo deklaroi se tubimet janë një e drejtë demokratike dhe themelore.

Sipas zyrtarëve të BE-së, trazirat në Serbi nuk do të ndikojnë në agjendën e vendosur të dialogut Kosovë - Serbi sepse këto dy gjëra nuk "janë të lidhura".

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, të mërkurën tha se protestat synojnë ta dobësojnë pozicionin e Serbisë para vazhdimin të bisedimeve me Kosovën të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Hungaria do t'i rishikojë rregullat e udhëtimit me vendet fqinje



BUDAPEST, 9 KORRIK - Hungaria do t'i rishikojë rregullat e udhëtimit me vendet fqinje, ku numri i të infektuarve nga koronavirusi është në rritje.

Gergely Gulyas shef i stafit të kryeministrit hungarez Viktor Orban, tha se rishikimi i rregullave do të vlejë për Serbinë, Kroacinë, Slloveninë, Sllovinë dhe Austrinë. "Në këto vende numri i rasteve me

Covid-19 është rritur në dy javët e fundit", tha ai.

Shtabi i krizës i qeverisë hungareze do të takohet më vonë të enjten për të diskutuar rregullat e reja të udhëtimit.

Hungaria ka hequr masat e izolimit dhe ka rihapur kufijtë në muajin qershor për udhëtarët nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe vendet fqinje jo-anëtare.

Hungaria, e cila ka një popullsi prej rreth 10 milionë banorësh, ka regjistruar 4 220 raste të të infektuarve me koronavirusin e ri dhe 591 viktima.

Më herët edhe Austria lëshoi paralajmërimet e udhëtimit për Bullgarinë, Rumaninë dhe Moldavinë për shkak të përkeqësimit të situatës epidemiologjike në ato shtete.

KS i OKB-së nuk e miratoi rezolutën ruse për Sirinë

NYU JORK, 9 KORRIK - Një draft-rezolutë e Rusisë për vazhdimin e ndihmës humanitare për Sirinë e shkatërruar nga lufta ka dështuar në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, tha të mërkurën ambasadori gjerman në OKB, Christoph Heusgen. Propozimi rus ishte një kundër-rezolutë ndaj projekt-rezolutës gjermano-belge ndaj së cilës vendosen veto Rusia dhe Kina. Vetëm katër vende votuan për

projekt-rezolutën ruse - Rusia, Kina, Vietnami dhe Afrika e Jugut. Shtatë të tjera, përfshirë Gjermaninë, ShBA-në, Britaninë e Madhe dhe Francën, votuan kundër. Katër vendet e mbetura abstenuan. Misioni i Gjermanisë në Kombet e Bashkuara tha se propozimi i Rusisë nuk i plotësonte kërkesat themelore të përshkruara nga Zyra e OKB-së për çështje njerëzore ose nga organizatat joqeveritare. OKB-ja ka dërguar ndihma në



Siri që nga viti 2014 përmes vendkalimeve kufitare që nuk kontrollohen nga qeveria

siriane. Rusia, mbështetësja kryesore e presidentit sirian Bashar al-

Asad, ka kërkuar që ndihmat të shpërndahen përmes vendkalimeve kufitare që kontrollohen nga qeveria siriane. Ndihi aktualisht kalon nëpër dy pika kufitare, ndërmjet Turqisë dhe Sirisë, njëra në Bab al-Salam, e cila të çon në rajonin e Alepos, tjetra Bab al-Hava, për rajonin e Idlibit të kontrolluar nga opozita siriane. Që nga shpërthimi i konfliktit në Siri në mars të vitit 2011, disa vlerësime thonë se të paktën 500 000 njerëz janë vrarë.

Mbi 12 milionë të infektuar nga koronavirusi në botë

NYU JORK, 9 KORRIK - Mbi 12 milionë njerëz në botë janë të infektuar me koronavirus, sipas të dhënave të Universitetit "John Hopkins". Rreth një e katërta e tyre janë në Shtetet e Bashkuara. Në këtë vend, rastet e reja po vazhdojnë të shënojnë rritje, kryesisht në shtetet perëndimore dhe jugore: Florida, Teksas, Arizona dhe Kaliforni. Që nga zbulimi i rasteve të para në muajin dhjetor në Kinë,

Shtetet e Bashkuara janë bërë vendi më i prekur nga pandemia, me më shumë se tre milionë raste të diagnostikuara dhe të paktën 132 256 vdekje, që është pak më pak se një e katërta e 548 000 vdekjeve në të gjithë botën. Jashtë ShBA-së, numri i rasteve po rritet në Brazil, i cili ka 1.7 milion të infektuar dhe India me 742 000 raste të konfirmuara. Meksika, gjithashtu, njoftoi për

6 995 rastesh të reja, duke e kapërcyer Spanjën me numrin e përgjithshëm të të infektuarve me më shumë se 275 000. Deri më tani në Meksikë kanë vdekur 32 796 persona. Në Australi, 5 milionë njerëz janë izoluar në qytetin e dytë më të madh të vendit, Melburn. Banorëve u është thënë që të qëndrojnë në shtëpi për gjashtë javë për ta parandaluar përhapjen e Covid-19.




Don Xhoni, romantik në këngën e re, publikon 'Baby'



Një këngë e re është publikuar nga reperi i ri, por shumë i suksesshëm, Don Xhoni. Ai ka sjellë me një videoklip shumë veror këngën me titullin 'Baby', në të cilën i këndon një vajze

me fjalë romantike. Edhe kjo këngë, si thuajse të gjitha publikimet e tjera të reperit, ka arritur që në pak orë të ketë shumë shikime, duke u dëgjuar e duke u shpërndarë gjithandej.

Kourtney Kardashian debuton me modelin e flokëve 'bob' në revistën "Vogue" të Arabisë



Kourtney Kardashian shfaq një pamje të re befasuese në kopertinën e edicionit korrik/gusht të revistës 'Vogue' të Arabisë ndërsa diskutonte për jetën pas televizionit. Ylli i "Keeping Up with the Kardashians" vjen në formë

të mahnitshme, teksa ka debutuar me stil të ri të flokëve, atë 'bob'. Ajo konfirmoi se po largohet nga shfaqja televizive që filloi në vitin 2007, përfshirë këtu edhe problemet e fundit që kishte me motrën e saj, Kim Kardashian.



Kanye West: Kam qenë i infektuar me Covid-19 që në muajin shkurt

Disa ditë pasi shpalli kandidaturën e tij si president i ShBA-së, Kanye West ka dhënë një intervistë për Forbes, ku i ka thënë të gjitha, nga ambiciet e tij politike deri te pandemia dhe vaksina kundër Covid-19. Ai ka thënë se ka qenë i infektuar me Covid-19 që nga muaji mars.

"Kisha të dridhura, temperaturë, kam bërë dushe të nxehtë dhe kam parë video informuese se si mund të kalohet koronavirusi në shtëpi. Mbaj mend se dikush më kishte thënë se Drake kishte koronavirusi dhe përgjigja ime ishte: 'Drake nuk mund të jetë më i sëmurë se unë', u shpreh ai.

Usain Bolt, baba për herë të parë, poston foto të vajzës



Aletit olimpik Usain Bolt njoftoi se tashmë është baba krenar i një vajze. Ai dhe partnerja e tij Kasi Bennet janë bërë prindër për herë të parë më 14 qershor, por vetëm pak orë më parë ai vendosi të publikojë disa foto të vogëlushes së tij. 33-vjeçari postoi një sërë fotosh të partneres së tij me një fustan të gjatë klasik teksa mban në dorë vajzën e porsalindur. E vogla quhet Olympia Lightning dhe gëzon shëndet të plotë.





Arb Elo: Piramidale

1. Pas njëzet e ca vjetësh prej botimit të parë, u bëra mbarë të lexoj "Piramida" e I. Kadesës, për një sërë arsyes: nuk kam qenë aty kur është publikuar te "Rilindja Demokratike"; kur jam gjendur në Tiranë ose më ka dalë nga mendja, ose edhe nuk e kam gjetur kur e paskam kërkuar.

Mirëpo shpejt u ndjeva me fat që nuk e paskam lexuar asokohe; nuk do të kisha patur qetësinë e duhur atëbotë për ta lexuar këtë libër siç duhet, siç edhe vetë autori, cilido autor, ma do mendja, pret të lexohet, si shkrimtar, si estet, e jo si tribun i vegjëlisë apo bacë i dherave ku shkelën të parët.

Edhe më shumë iu gëzova edhe vetes sime, lexuesit në mua, të cilit nuk i duhet më tashmë, nuk po kërkon më të gjejë mes rresh-tash kumte sekrete disidente e as të qëmtojë alegori të largëta apo të afërta, ndonëse ato mund të gjendeshin e gjenden aty me shumicë e pa shumë mundim. Por nuk po dua më të lexoj asisoj dhe i gëzohem leximit të një libri që vjen nga Mëmëdheu sikur dëgjimit të një simfonie, leximit estetik të tij. Nuk dua, jo se i trembem përbaljes me të kaluarën, as se kërkoj ta harroj atë; thjesht, përvoja jetësore më ka mësuar të mos merrem më me gjëra, shtjellën e së cilave nuk e ndikoj, nuk e ndryshoj dot.

Ka boll padrejtësi e dhimbje e luftë e ligësi kjo botë, mirëpo duhet bërë kujdes, e këtë paskam mësuar nga disfatat, me dozën e përditshme të helmit që merr nga media, nga njerëzit, nga lajmet, nga gjithçka – fundja, atë që po kërkojmë ta arrijmë për të tërë, duhet të shohim ta vëmë në jetë ne vetë të parët: ndonjë shëtitje të

qetë, ndonjë bisedë të këndshme me miq, ndonjë libër të mirë, ndonjë pikurë të bukur e ca muzikë të mirë; për këtë jetohet fundja, apo?

Me një fjalë, i gëzohem faktit, që marr një libër në dorë e nuk më duhet të pyes: »Çfarë ka dashur të na thotë autori me të?«, pyetje kjo mbase në kohëra totalitare mëse e këshillueshme, por jo për lexuesin në liri, bashkësi kjo ku mund ta llogaris veten, për fatin tim të keq apo të mirë, vetëm përgjysmë.

2.

Para disa vitesh, ndërsa gjendesh në Tiranë, po bisedonim me dy miq në një kafene diku pas piramidës. Asokohe zhvillohej debati në parlament, për prishjen apo ruajtjen e saj, të cilin nuk e kisha ndjekur në hollësi, porse për të cilin isha deri diku në dijeni, pasi nuk i shpëtoje dot; të gjitha gazetat online e kishin në faqen kryesore e mund t'u bishtnoje shkrimeve, por jo titujve, që të goditnin sapo klikoje ndonjë faqe.

Shpejt vura re në Tiranë se tema kish zënë vend edhe në bisedat e përditshme; tre a katër të njohur që kisha takuar më kishin treguar idetë e tyre për të; të djathtët qenë për prishjen e saj, të majtët për rehabilitimin dhe ruajtjen, madje pata dëgjuar edhe të tjerë që flisnin për vlerat e saj arkitektonike. E pasi mbaronin së shfryri dufin e tyre, ndoshta mllëfin, me të kaluarën, me shtetin, me botën, në mos me veten e tyre, por edhe me tjetrin në mënyrë të pandërgjegjshme, që në këtë rast i binte të isha vetë, kujtoheshin pastaj se jam i fushës dhe, për të patur ndoshta edhe alibinë e monologut që kishte paraprirë,

ndërmendeshin të më pyesnin së fundmi se ç'do të bëja unë me të, me piramidën domethënë.

Njëri nga miqtë e mi, pasi qemë pyetur me si jeni, e nga familja, e të gjithë mirë, hapi edhe ai këtë temë, duke e treguar me dorë në një gjest domethënës ngrehinën. »Unë them ta bëjnë muze për të përndjekurit«, tha dhe, pasi kishte argumentuar gjerë e gjatë se pse ajo duhej të bëhej e tillë, muze pra, nuk harroi edhe ai të na pyeste ne dy të tjerët se ç'do të bënim me të, nëse do të mundeshim.

Ashtu si edhe të tjerët, ai e shtroi pyetjen bardhezi, duhej prishur apo duhej mbajtur, por edhe nuk ngjante fort i interesuar për përgjigjet që i binte të merrte prej nesh, gjykuar nga shprehja e vagullt e përhumbjes që i ra në fytyrë, kur mbaroi së foluri vetë e që i bie shumëkujt në Shqipëri përgjatë bisedës, kur tjetri kërkon ta dëgjojnë atë vetë, porse pak i bën për të dëgjuar të tjerët.

»Mua kjo gjëja«, ia nisi miku tjetër, »sidomos e parë këtë nga pas, më ngjan me të pasmet e një shqiponje të bastarduar prej betonarmeje, e shartuar me një yll, po prej betoni, një farë kimere e neveritshme e dhunës me absurditetin, e ateizmit me paganizmin stalinist; me një fjalë: po të ishte për mua e nëse do të mundesha, do ta kisha shkukur qysh tani, si të thuash, nuk do t'i lija dy gurë bashkë. Më kujton, kur e kundroj, një kërmë ndanë rrugës, por edhe më shumë akoma, - po të mos qenë rropullitë, që i kanë mbetur ende, dhe mizat që i vijnë vërdallë (ca njerëz që hipnin e zbrisnin lart e poshtë), si edhe grafititë, - më kujton pra skeletin e një dinosauri, një tireksi, që, falë Zotit, nuk

është më gjallë, përndryshe do të na kishte shqyer të gjithëve. Mendo sikur kjo godinë të ishte e mirëmbajtur e bashkë me të edhe diktatura e tash të kishim mbi krye brezin e tretë të diktatorëve, se si do të na dukej.

Do ia hiqja rropullitë fare, do e lija veç skelet, si mbetjet e një ndërtese në Hiroshima, funksioni i së cilës nuk po më kujtohet, por që është lënë në mes të qytetit, tashmë modern, si përkujtimore e bombës atomike që u hodh aty; bomba që hodhi Enver Hoxha këtyre anëve, trutë e gomarit që u hodhi njerëzve, është e njëjta gjë, pak a shumë. Kinse simbolizon një shqiponjë që bëhet gati të çohet në fluturim, porse mua më ngjan me një merimangë.

Më erdhi për të qeshur me ç'tha, ndërkohë që bashkë me mumien e paqenë të Hoxhës, m'u asociua kushedi pse me një skenë nga "Zoti i unazave", ku një merimangë gjigante e mbështjell personazhin me fije, e bën kokon. M'u përshfaq diktatori i mbështjellë ashtu me fasha, kur u bënë homazhet diku te Kuvendi Popullor (apo paska qenë Instituti i Arteve?), i mbështjellë si kukurec, si plënc i qepur, me penjë mëndafshi, por më kishte ardhur radha për të thënë diçka e të dy po prisnin të flisja, jo pa ligësinë e kujt pret që ti të gabosh, të bësh gafën, rastin për të të zënë gafil me fjalët e tua, - kështu të paktën më ngjau e kishte fort të ngjarë që ligësia që po projektoja tek ata të ishte ligësia ime, që buronte nga pafuqia që të zë kur Qoftëlargu largohet nga kjo botë mirë e bukur e pa i hyrë gjemb në këmbë, - sidoqoftë e zura fillin dhe u pozicionova menjëherë në pozicionin më të rehatshëm në

një bisedë, në atë agnostik.

»Shiko«, më bëhet se paskam thënë, por ndoshta edhe vetëm e kam menduar këtë, »nuk mund të them asgjë pa u njohur me objektin; do të më duhej të shikoja planet e ndërtimit, ta vizitoja nga brenda, të mendohesha: e gjitha kjo do të hante disa muaj, porse edhe nëse do i kisha bërë të tëra këto, nuk është e thënë se do të më kishte lindur me patjetër ndonjë ide që do t'ia vlente...«

»Më habit«, shtova pas një heshtjeje, »mënyra se sa shpejt priten drutë këtyre anëve, se sa shpejt e atypëraty parlamenti vendos jo vetëm prishjen, por zgjedh edhe projektin fitues të ngrehinës së radhës. Mirëpo parapëlqimet e mia personale, nëse flasim për objekte të tilla, duhen lënë mënjanë e, nëse do të isha shefi i kësaj pune, do të përiqesha ta shikoja çështjen më me objektivitet, gjë që është, natyrisht, vetëm deri diku e mundur. Një gjë është e sigurt: ky përbindësh nuk ka asnjë vlerë arkitektonike e as ndonjë estetike; nëse ka të tilla i bie të jenë ose të natyrës historike, ose të asaj muzeale. Tani, edhe ai palati atje me njëzet e ca kate, edhe ai gërmadhë fringo e re është, parë kështu, e po ndërtohet mu tani bash në qendër të Tiranës, pa çka se nuk ka mbaruar akoma, por të paktën nuk ka ngarkesën emocionale të diktaturës, ndonëse ka një tjetër asisoj, atë të kapitalizmit vulgar, të çoroditjes së pafrë. Dikur na vrau e preu Enveri, qeveria, shteti; sot të qërojnë vrasës gjaknxehtë a gjakftohtë, gjakmarrës, tipa me silenciator a me pump-gun, dealer-a droge, apo ndonjë i fortë që nxehet kot në kokë të vet; dikur na morën në qafë parimet; tani po

na merr mungesa e përfarshme e tyre.

Natyrisht që unë nuk jam idiot që të pohoj se tani qenkësh po aq keq sa edhe nën diktaturë, apo edhe më keq akoma: që atëherë ishte më mirë; e tashmja është në njëfarë mënyre vijimësia e së shkuarës e nëse nuk duam të jetë kështu, do të na duhej të ndaheshim përfundimisht prej saj duke e përpunuar, jo duke e zhbërë, thjesht sepse kjo e fundit është e pamundur. Por, më tepër se aq, jam pothuajse i lumtur që aq më bën se ç'ndodh me të, pasi problemi i vërtetë nuk qëndron te ndërtesa, por në mendjet e njerëzve; janë ish-bashkëpunëtorët e Sigurimit, por edhe të përvuajturit e asaj kohe, ne të tërë thuajse, që e kemi vetëdijen e trazuar, vetëdijen e fajit, pasi të tërë e dinë se këtu ka ndodhur një krim. Me një fjalë, piramida e vërtetë gjendet në trutë e gjindjes, ndërsa kjo këtu, e përsërita vetë tash gjestin e mëparshëm të mikut, duke e treguar me përcmim, »është vetëm një kopje e mjerë e arketipit të botës ideale, sipas Platonit, po të duash.«

“Pra, do e mbaje.», vuri pikat mbi i miku, të cilit i pata kopjuar gjestin, ndonëse nuk ishte kjo ajo që kisha dashur të thoja.

3.

Kur u ndamë e u largova nëpër zheg i vetëm, tema e bisedës më ndiqte pas si një pulëbardhë vazhden që lë në ujë anija. E kjo nuk kishte të bënte me ngrehinën në fjalë; nuk ishte ajo që nuk më lëshonte, por simbolika e arketipit piramidale si e tillë.

Në zanatin tim është e zakonshme të përballesh me figurat elementare dydimensionale në letër e më pas me trupin në realitet, me dimensionin e tretë.

Janë tre figura arketipale; trekëndëshi, qarku dhe katrori. Në artet figurative, veçanërisht në arkitekturë, është e këshillueshme të mos përdoren të trija sëbashku, për të shmangur eklektizmin, por e shumta dy të tilla, gjë që shpesh është e detyruar nga tredimensionaliteti dhe kompleksiteti i formave dhe funksioneve. Çdo kombinim tjetër më kompleks është veçse fraktal i këtyre tre elementëve bazikë.

Nëse do të provohej, në një përpjekje të thjeshtëzuar, të rrokeshin kahjet e artit, - e jo vetëm të tij, por edhe i gjithë mudi botëkuptues i feve, filozofive, shkencave, etj., - këto kahje mund të ndaheshin në mënyrë, e përsëris, fort naive e të thjeshtëzuar, ndoshta vulgare, në dy kampe të mëdha, në dy prirje themeltare.

Njëri kah është ai që merret drejt reduktimit, zbërthimit të gjithçkaje në emëruesin më të vogël të mundshëm, pikës, drejt zeros, atomit të Demokritit, monadave të Leibnicit, monoteizmit mbase; tjetri është ai pagan, pluralitetit të zotave, hinduizmit, bigëzimit aristetotelian, multiverseve.

Në epoka të ndryshme e stilet artistike gjendet e njëjta sinusoidë. Ndërsa arkaizmi priret drejt arketipit, epoka klasike mëton të gjejë masën e duhur, më pas vjen baroku, rokokoja, ornamentit e pastaj kurba nis të priret sërish drejt thjeshtëzimit.

E tëra kjo përkon edhe me vetëdijen jo vetëm estetike të njerëzimit, por edhe me ngritjet, shkëlqimet dhe rëniet e tij; me luftrat, epokat e arta, shkatërrimet, përmbytjet e kështu me radhë.

Ndodh, më shpesh se ç'mendohet, që të dyja prirjet e lartpërmendura të fqinjërojnë pranë e pranë. Nëse piramida është shembëlltyra e përsosur e reduktimit, labirinti është shembëlltyra e përsosur kah harlisja. Në Egjiptin e vjetër, ndërsa piramidat i kanë mbijetuar kohës, labirinti, i cili, sipas Herodotit, tejkalonte çdo përfytyrim, madje edhe piramidat vetë, ka patur fatin e përkundërt.

Arketipet, me sa duket, janë më solide, më stabile, jo vetëm nga ana statike, se fraktalet e tyre. Por ka edhe diçka më elementare se vetë piramida: shkretëtira. Njërin me tjetrën i lidh era, rëra, reduktimi i gurit në emëruesin më të vogël të përbashkët, me hiçin; nëse piramida do të shprishet e do të frynte erë ndërkaq, çka do të mbetej prej saj do të ishte vetëm lëndë shkretëtire, një valle rëre.

4.

Kjo përsiatje m'u ndërmend edhe një herë kur mbarova së lexuari "Piramida" të I. Kadaresë. Ky është ndoshta libri më shtypës, më kompakt, i tij; ka fort dendësi edhe te "Pallati i Ëndrrave", por ngjashmëria fqinjërore është si ajo e piramidës me labirintin; vetëm dendësia atmosferike dhe lënda e përdorur, lëndë makthesh, të ngjallin asociacionin e fqinjërisë.

Ndërsa për nga stili, për nga intermezzo-t (nga kronika) romani të kujton "Kronikë në gur" dhe "Kështjella", këtë të fundit edhe më tepër, pasi, nëse te ky sulmohet një kështjellë, te "Piramida" po ngrihet një e tillë, që nuk do mbajë të gjallë të rrethuar brenda, por vetëm një të vdekur të rrethuar prej gurësh. Me një fjalë, rrëfimin e kështjellarit arbër, subjektin njerëzor, vendin e tij, e merr guri, guri i lëvizur me mundime të mëdha sizifiane prej të gjallësh që shpesh shtypen prej tij, bien rrugës nga ngjitja e tij në majë; Sizifi dhe guri ndërrojnë vendet; këto intermezzo janë edhe zemra e romanit e janë të shkruara fort mjeshtërisht.

Ndonëse pesha e gurëve, hetimet, ndëshkimet, përbetimet e denoncimet, krijojnë te lexuesi një kapllim shtypës, me një fill të hollë humori të zi rrëzëllitës autori ruan drejtpeshimin mes makabritetit e zyrtësisë, nga njëra anë, dhe lehtësisë efemere të absurdit, të përsëritjes së his-

torisë deri në mërzë, nga ana tjetër. Ambasadori sumer që i nis raportet sekrete shtetit të tij me qerre plot me pllaka të shkruara argjili; bathët (nënkupto; fasulet, groshët tona) për të cilat njerëzit mbajnë radhë; jeta pas vdekjes e faraonit Snefru, e cila mund të përkthehej edhe si ajo e Enver Hoxhës: një ditë, pastaj edhe një ditë tjetër... pastaj vijnë shokët Gogo Nushi, Hysni Kapo dhe Kadri Hazbiu për një mbledhje të organizatës, edhe një ditë, një tjetër ditë... i japin së tërës një frymë lojcake rrëzëllitëse, që i rri bukur asaj të përzishme, që përshton tekstin fund e krye.

5.

Po flisja ca më sipër për kohë leximi; nuk ishte e njëjta gjë të lexoje para '90-ës; tjetër gjë është po ashtu të lexosh nga '90-ta e këtej. Leximi në robëri është i ndryshëm nga ai në liri, por edhe ky i fundit varet nga lloji i lirisë në të cilën gjendesh.

E njëjta gjë i ka ndodhur, me sa duket, edhe autorit gjatë shkrimit të këtij romani; ndërsa treçereku i librit është shtypës, alegorik dhe asociativ, nga kreu i XII (Dhunimi) e deri te ai i XV (Kafkana) stili ndryshon papritur, syri gjithëparës, - siç tregohet ky në teorinë konspirative, ku nuk harrohet të përmendet simboli masonik mbi dollar, por që mund të krahasohej me këndvështrimin e një autori të gjithëdijshëm, - syri gjithëparës pra, piramidioni, si të thuash, i cili deri më atëherë ka qenë panoramik, vjen e fokusohet te personazhet: e gjitha kjo është shkruar fort bukur e mjeshtërisht, porse nuk është në vazhden e asaj që e ka paraprirë. E njëjta gjë ndodh edhe me paralelen e hequr me Timur Lengun dhe spagatën me bunkerët e Shqipërisë; faqja e fundit, për shijen e shkruarit të këtyre radhëve, është mëse e tepërt.

Pjesa me Timurin e çalë është e shkruar dhe ajo fort mjeshtërisht e do të kërkonte një shkrim më vete, mirëpo filli që e mban lidhur me rruazat që i kanë paraprirë është i hollë dhe i kërkuar, metafora si e tillë, simbolika e saj, mund të gjendej në gjithë piramidat e kësaj bote, qysh nga majat e Amerikës Jugore e deri në Kinë e Indonezi.

Shkruesi i këtyre radhëve është vetëm lexues e ka fort të ngjarë të gabohet; sidoqoftë ai mendon se pjesa "Kafkana" duhej të ishte nxjerrë diku më vete, si novelë më vete; por është e kotë të supozojmë për fatin e saj, pasi ajo është tashmë e përfshirë në roman e ky i fundit është fakt i kryer; mund t'i sugjerohej lexuesit, pasi të kish mbërritur te kreu i XII-të, ta linte librin për ca kohë mënjane, të lexonte diçka tjetër në mes, pastaj të vazhdonte deri te kreu i XV-të e të bënte të njëjtën gjë edhe me pjesën e mbetur.

Me sa duket, edhe për autorët vlen thënia e vjetër e Heraklitit: "Askush nuk zbret në të njëjtin

lumë dy herë njëlloj" e romani nuk është shkruar në vijimësi, por në gjendje të ndryshme krijuese, ndoshta edhe lirije.

Mirëpo, ashtu siç ka një kohë leximi, një të tashme të tij, po ashtu ka edhe lexime të shkuara, një kohë pasleximi, e kur lexoj se ç'paskam shkruar më sipër në një kohë të tillë pasleximi, mendoj se ndoshta ajo që shkrova për fillin që i lidh pjesët me njëra-tjetrën kishte kuptim përgjatë leximit, por jo më tani, për pasleximin, ashtu si shija e disa ushqimeve të zgjedhura të vjen ca me vonesë, pasi i ke përtypur ato. Ndaj, tani, në një kohë të dytë, kur sjell ndërmend dy imazhet bazë të kësaj novele, piramidën prej guri të Keopsit e atë me kafka të Timur Lengut, më duket papritur se tash ata rrinë për bukuri përbri njëri-tjetrit. Çka e lidh piramidën me labirintin, shartimi i tyre, si të thuash, i reduktimit maksimal me mëtimin e pafundësisë është po ashtu stuhia e rërës, labirinti i shkretëtirës, diçka amorfë, kaotike, e pështjelluar, e panënshtueshme dot, diçka si era, po, turma, thashethemnjaja, piramida e shpirtrave, e ëndrrave, piramida prej rëre.

E kjo është edhe lënda e vërtetë e këtij romani.

6.

Pas piramidave të Gizesë, shumëkujt do t'i vinte ndër mend, nëse do të përmendej kjo fjalë, një e tillë moderne prej qelqi në hyrje të muzeut të Luvrit. Pakkush, besoj, e ka patur mendjen, pas gjithë asaj mësymjeje kulturore që pëson vizitori në muze, kur ka dalë prej andej e ka marrë ndoshta përposh për në metro, që të ngrejë kryet e të shohë një piramidë xhuxhe të varur në nënkallim, një kundërpiramidë, nëse nuk më gënjen kujtesa. Ndoshta gjithçka ka nevojë për të kundërtën e vet, pasqyrimin e vetvetes, ku të mund të kundrohesh, ku do të mundte të plotësohte me tjetrën gjysmën e gjymtë. Strukturat njerëzore, në të gjitha kohërat, edhe në ato demokratike, kanë

qenë hierarkike, piramidale. Ndoshta, ndonëse kjo është utopike, do të na duhej të mëtonim ca më shumë për të tjera forma po aq të përsosura, në të cilat pikat janë të barazlanguara nga qendra, struktura rrethore pra, në mos sferike. Mirëpo në paragrafin e mësipërm ka një të panjohur të madhe: ne, njeriu. Fort është përpjekur të ndryshohet ai, të gjykohej, të ndahet gruri nga egjra, fort është keqkuptuar ai, prej kujt? Prej atij vetë.

Kafkat tona janë gurët me të cilët kemi ndërtuar piramidat tona, shpesh fort të pjerrëta.

7.

Idetë e dy miqve të mi nuk po më ngjajnë, tani që hodha këto radhë, aq të këqija; më mirë akoma, mendoj, do të kishte qenë një kombinim i tyre.

Pasi t'i hiqim rropullitë mumies, piramidës së Enver Hoxhës, e t'i linim vetëm skeletin prej beton-armeje, mund ta mbushnim kafazin, burgun e krijuar, me kafka, me kafka porcelani ndoshta, ashtu si Ai Weiwei pat mbushur dikur një sallë ekspozite me fara luledielli porcelani. Numri i kafkave mund të logaritet lehtë.

Ndërsa në majë, aty ku dikur gjendej ylli pesëcepësh, mund të vihej mbikafka, kafka e ndonjë koke të madhe, më të marrit të anëve tona, e cila, nëse pushteti është marrëzia më absolute e ka shumë të ngjarë të jetë ashtu, do i binte të ishte e kujt?...

Por kjo është vetëm një ide e marrë hua nga libri e ndaj le ta lemë më mirë mjeshttrin të flasë vetë:

(...) Duke qeshur e duke u tallur kërkuan ndonjë kokë të stërmadhe, por meqë nuk e gjetën aq sa ç'e kërkonin, dikush u kujtua për Mongkën, një torollak kokëmadh, nga ata që ndiqnin pas karvanët ushtarake. E thirrën budallanë, i thanë: »do të bëjmë princ« dhe, pasi ia prenë kryet nën gazmendin e të gjithëve, i derdhën plumb të shkrirë sipër çaçkës dhe ia vendosën në majë. (...) /Exlibris



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita vazhdon rrugëtimin drejt titullit

Skuadra e Dritës është edhe më afër titullit, pasi me fitoren e arritur të enjten ndaj Feronikelit, ka ruajtur dallimin në renditje me skuadrat përcjellëse. Flamurtari ka bërë një hap të madh drejt mbetjes në elitë pas fitores ndaj Dukagjinit, kurse Trepça '89 ka lëshuar dy pikë në përballje me Vushtrrinë



Dushi. Me tri pikët e reja, Flamurtari është ngritur në kuotën e 40 pikëve dhe pozicionohet në vendin e shtatë, kurse Dukagjini, i cili në edicionin e ardhshëm do të bëjë gara në Ligën e Parë, është i fundit me vetëm 10 pikë.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 KORRIK - Skuadra lidere e Superligës, Drita nga Gjilani, vazhdon rrugëtimin drejt titullit të kampiones në IPKO Superligë. Të enjten në Gjilan e ka mposhtur kampionin në fuqi të Superligës, Feronikelin (2-1). Erjon Vucaj ka shënuar në pjesën e parë për rezultatin 1-0, kurse njëmbëdhjetë minuta pasi ka filluar pjesa e dytë mysafirët kanë barazuar nëpërmjet Besmir Bojkut. Në minutën e 67 Fidan Gërbeshi e ka rikthyer epërsinë e vendësve me golin e shënuar nga penalltia.

Pas tri pikëve të reja, Drita është e para me 64 pikë të grumbulluara, kurse "Nikli" zë vendin e pestë me 44 pikë. Trepça '89 ka bërë një gabim të madh në garën për mbijetesë, pasi ka barazuar në ndeshjen e zhvilluar në "Riza Lushta" nga Vushtrria (1-1). Pjesa e parë e kësaj ndeshje është mbyllur 0-0, kurse mysafirët nga Vushtrria arritën të kalojnë në epërsi në minutën e 79, kur Drilon Fazliu ka realizuar për rezultatin final 0-1. Vendësit janë munduar në maksimum dhe arritën të marrin një barazim me golin e shënuar në minutat shtesë (1-1) nga Arb Manaj. Ky barazim mund t'i kushtojë skuadrës nga

Mitrovica në garën për mbijetesë, pasi tash është në pozitën e nëntë me 35 pikë, ndërsa pika e fituar nga Vushtrria është e pavlefshme, pasi tashmë kjo skuadër matematikisht e ka siguruar rënien nga Superliga. Në ndeshjen e zhvilluar në kryeqytet në mes të Flamurtarit dhe Dukagjinit nga Klina janë shënuar plot shtatë gola, kurse

fitues ka dalë Flamurtari me rezultat 4-3. Flamurtari krijoi epërsi prej tri golave, por në fund rrezikoi ta lëshojë fitoren nga duart. Bashkim Shala shënoi dy gola për kuqezinjtë e kryeqytetit, kurse nga një e shtuan Maliqi dhe Lloga. Nga penalltia dështoi të shënojë Shend Kelmendi. Ndërsa për mysafirët nga Klina dy gola i realizoi Kamara dhe një tjetër

IPKO Superliga

Drita - Feronikeli	2-1
Trepça '89 - Vushtrria	1-1
Flamurtari - Dukagjini	4-3
Gjilani - Prishtina	2-1
Ballkani - Llapi	5-1
Drenica - Ferizaj	3-0

Tabela		PIKË
1. Drita	29	64
2. Ballkani	29	59
3. Gjilani	29	58
4. Prishtina	29	57
5. Feronikeli	29	44
6. Flamurtari	29	41
7. Llapi	29	39
8. Drenica	29	38
9. Trepça '89	29	35
10. Ferizaj	29	26
11. Vushtrria	29	18
12. Dukagjini	29	10

FFK-ja, pas incidentit në Gjilan: Klubet duhet të jenë më të matura

"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 KORRIK - Për incidentin e ndodhur të mërkurën në Gjilan, pas ndeshjes në mes të Gjilanit dhe Prishtinës (2-1), ka reaguar edhe Federata e Futbollit e Kosovës. Komisioni i Garave i FFK-së ka vlerësuar se ky kampionat është një nga më interesantët që nga paslufta, ku si gara për titull ashtu edhe ajo për mbijetesë është e madhe dhe e paqartë. Një gjë të tillë, sipas KG-së, padyshim ka ndikuar edhe në rritjen e rivalitetit dhe të cilësisë në futboll, por natyrshëm e ka rritur edhe presionin te klubet dhe te zyrtarët e ndeshjeve. Komisioni i Garave ka kërkuar nga klubet që të jenë më të matura. "KG shpreh shqetësimin

për ngjarjen e fundit të ndodhur në Gjilan, në ndeshjen Gjilani - Prishtina, që krijon imazh të keq për futbollin tonë. Për këtë ngjarje KG do të diskutojë dhe do t'i shqyrtojë të gjitha provat dhe materialet zyrtare në mbledhjen e radhës pas përfundimit të ndeshjeve të javës së 29-të në IPKO Superligë. Me këtë rast apelojmë që klubet të përmbahen nga deklaratat e pamatura dhe veprimet e dhunshme, veçmas nga zyrtarët e klubeve, të cilët në shumë raste po nxisin situata të pakëndshme brenda fushës së gjelbër. Njëherësh kërkojmë edhe nga trajnerët që të jenë shembull i mirë dhe ta ruajnë gjakftohtësinë. Apelojmë edhe te gjyqtarët që ta bëjnë punën e tyre në mënyrë sa më profesionale



dhe të mos bien pre e presioneve apo ndikimeve", thuhet në reagimin e Komisionit të Garave të FFK-së.

SC Gjilani: Ne nuk ishim të përfshirë në incidentin pas ndeshjes

Për incidentin e ndodhur pas ndeshjes Gjilani - Prishtina ka reaguar edhe skuadra e Gjilanit. Ky klub ndihet i pafajshëm për incidentin e ndodhur, pasi asnjë

lojtar apo zyrtar i klubit nuk ka qenë i përfshirë në të. "Gjatë zhvillimit të ndeshjes ka pasur reagime të vazhdueshme nga banka e KF Prishtinës ndaj vendimeve të arbitrave të ndeshjes. Sidoqoftë, ndeshja ka qenë e karakterizuar me lojë të fortë nga të dyja ekipet. Me të përfunduar ndeshja, shumë lojtarë dhe anëtarë të stafit teknik janë vërsulur në drejtim të gjyqtarëve të cilët ishin marrë në mbrojtje nga zyrtarët policorë të Njësisë Speciale (të angazhuar nga FFK). Zyrtarët Policorë kanë përdorur sprejin për ta ndaluar sulmin ndaj gjyqtarëve", thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit. "Asnjë zyrtar apo lojtar i SC Gjilanit nuk ka qenë i përfshirë në këto incidente dhe ne si klub nuk mbajmë asnjë

përgjegjësi për ngjarjet e ndodhura me këtë rast. Gjithashtu, vlen të theksohet se edhe zhveshtoret janë dëmtuar pas ndeshjes", thuhet në këtë njoftim. Sipas njoftimit të klubit gjilanas, në fund të ndeshjes, kur zyrtarët dhe lojtarët e KF Prishtinës janë nisur nga stadiumi "Agim Ramadani-Katana", ka ndodhur edhe një incident. Sipas informatave nga Policia e Kosovës, një zyrtar i KF Dritës ka tentuar të sulmojë një zyrtar të KF Prishtinës. Kjo ngjarje ka ndodhur jashtë stadiumit. Gjithashtu, SC Gjilani ka kërkuar nga organet e FFK-së dhe organet e tjera shtetërore që këtë ngjarje ta zbardhin deri në fund dhe aktorët ta marrin dënimin e merituar.

Prizreni bëhet edhe me një fushë sportive

Prizren, 9 korrik - Infrastruktura sportive është e domosdoshme për ngritjen e nivelit të sportit në një vend. Në Kosovë së fundmi është duke u investuar shumë në stadiumet e futbollit, derisa Komuna e Prizrenit është bërë së fundmi me një stadium të

bukur, në të cilin do t'u mundësohet të rinjve t'i shpalosin vlerat që kanë. Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se të enjten është bërë përirimi i stadiumit në fshatin Sërbicë në Prizren. "Prizreni ka qenë gjithmonë vatër nga

ku kanë dalë futbollistët e njohur. Për ta vazhduar këtë traditë, ne si prioritet kemi vendosur investimin në sport dhe rini. Në këtë drejtim, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Emilija Redzeqi, kemi përruar stadiumin e

futbollit në fshatin Sërbicë, i cili është realizuar si investim i komunës. Ky stadium do t'u shërbejë klubeve sportive të Komunës së Prizrenit si dhe do të jetë në shërbim të futbollistëve të rinj, meqë i plotëson kriteret e kërkuara nga Federata e Futbollit për mbajt-



jen e garave regionale për grupmoshat e reja", ka thënë Haskuka.

Përfaqësuesja A e femrave do të marrë pjesë në garat zyrtare të FIBA-s

PRISHTINË, 9 KORRIK - Bordi i Federatës i Basketbollit të Kosovës (FBK) ka marrë vendim për paraqitjen e Përfaqësueses A të Femrave në garat zyrtare të FIBA-s, më saktësisht në FIBA Kampionatin Evropian të

Shteteve të Vogla, që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri më 20 qershor. Vendimi është marrë pasi është diskutuar më parë në bord dhe pas Analizave të bëra

për përfaqësueset e Kosovës në konkurrencën e femrave ndërmjet kryetarit të FBK-së, Arben Fetahu, sekretares së përgjithshme, Elvira Dushku dhe drejtorit të përfaqësueseve, Granit Rugova. Federata e Basketbollit e

Kosovës zotohet se do t'i bëjë të gjitha përgatitjet e duhura për paraqitje sa më të mirë të përfaqësueses sonë në garat e FIBA-s, ku për vashat tona seniore do të jetë hera e parë që do të marrin pjesë në një garë zyrtare të FIBA-s.



Albana Arifi: Kualifikimi nuk është i pamundur

PRISHTINË, 9 KORRIK - Hendbollistja e Përfaqësueses së Kosovës, Albana Arifi, ka respekt për kundërshtarët në kualifikimet për Botërorin 2021, por nuk e vlerëson të pamundur kualifikimin. Shorti i tërhequr të mërkurën ka bërë që Kosova të luajë me Austrinë dhe Italinë. Ndashjet do të luhen në fund të nëntorit apo fillim të dhjetorit në Austri. Kosova synon dy vendet e para që dërgojnë në fazën e dytë. Albana, që bën karrierë në Suedi, për herë të parë do të luajë në kualifikime për Botëror. "Ndoshta dikush mund të mendojë se kemi pasur fat në short, por unë personalisht kurrë nuk i nënvlerësoj kundërshtarët. Kam respekt për secilin ekip kundër të cilit garoj. Futem në fushë me seriozitetin më të madh dhe luaj sikur të përballim me ekipin më të fortë në botë", ka thënë Arifi për faqen zyrtare të FHK-së. Sipas lojtares shumë të rëndësishme për Kosovën, duhet të përgatitet maksimalisht dhe të hyjë në fushë për të fituar. "Jo rrallëherë ndodhë që ekipet të



cilat nuk janë llogaritur favorite, kanë befasuar. Italia dhe sidomos Austria janë ekupe me përvojë të gjatë dhe nuk do të jetë e lehtë të ballafaqohemi me to. Ne nuk kemi përvojë të gjatë në arenën ndërkombëtare dhe kjo nuk e bën më të lehtë ballafaqimin tonë. Kapitenia jonë, Leonora Demaj, është e lënduar dhe shpresoj shumë që deri në nëntor do të rikuperohet dhe

do të kthehet në fushë për ta udhëhequr kombëtaren tonë", ka theksuar Arifi që është në formë të mirë. Ajo është rregullisht e angazhuar te skuadra Lugj, po ashtu zhvillon ushtrime të rregullta individuale. "Nëse edhe bashkëlojtaret e tjera zhvillojnë ushtrime të duhura, shpresoj shumë se do t'ia dalim të kualifikohemi tutje", ka deklaruar Arifi.

Davis: Lakersat synojnë titullin kampion

ORLANDO, 9 KORRIK - Më 30 korrik do të rinisë sezoni 2019-2020 i basketbollit, me 22 ekipet e NBA-së që do ta vijnë betejën për titullin kampion. Një nga skuadrat pretendente për titull është Lakers, që në mars kishte rekordin më të mirë në Konferencën e Perëndimit. Trajneri Frank Vogel, pas mbërritjes në Orlando, ku me sistem grumbullimi do të luhen ndeshjet e mbetura të sezonit të rregullt e më pas "play off"-i, ka thënë: "Gjatë tetë ndeshjeve të sezonit të rregullt do t'u jap mundësi aktivizimi të gjithë lojtarëve, më pas do ta vlerësojmë situatën nga ndeshja në ndeshje. Do t'i përdorim këto sfida të para për ta parë gjendjen para fazës 'play-off'. Edhe djem të rinj që kanë luajtur pak do të aktivizohen, do ta kenë shansin e tyre. Në këtë periudhë është e



rëndësishme t'i përdorim të gjitha burimet që kemi në dispozicion", ka thënë Vogel. Ndërsa Anthony Davis, ylli i skuadrës, ka shtuar: "Shanset për titull mendoj se tani janë më të mëdha se në mars. Jemi

çlodhur gjatë këtyre muajve dhe gati për t'u rikthyer në fushë. Këto muaj i kanë bërë mirë trupit tim, pasi pata mundësi të rikuperoj nga disa probleme dhe të jem në 100 % të formës".

SHKURT

Milani, gati ta transferoj Rashicën

Milani pritet të bëjë një mini-revolucion në merkato nën drejtimin e trajnerit Ralf Ragnick. Sipas "Gazzetta dello Sport", përveç Shick, kuqezinjët po ndjekin edhe Milot Rashicën për sulm, i cili ka lindur më 1996 në Kosovë dhe ka kontratë me Werder Bremenin. Për ta marrë futbollistin shqiptar nevojiten 20 milionë euro, aq sa është klauzola e lirim të tij nga klubi gjerman. 24-vjeçari ka bërë një sezon fantastik te Werder Bremenin, duke tërhequr vëmendjen e shumë skuadrave të mëdha evropiane. Këtë sezon Rashica ka shënuar 8 gola dhe ka dhënë 7 asistime në 28 ndeshje.

Van Persie: Këta tre futbollistë meritojnë 'Topin e Artë'

Robin van Persie ka treguar emrat e tre futbollistëve që beson se meritojnë të jenë në podium për Topin e Artë, duke injoruar Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldon. Ish-sulmuesi i Arsenalit dhe Manchester Unitedit beson se sulmuesi i Bayern Munichit, Robert Lewandowski, duhet ta fitojë çmimin më të rëndësishëm individual. Dyshja e Premierligës, Kevin de Bruyne dhe Sadio Mane, njëri i Manchester Cityt dhe tjetri i Liverpoolit, janë dy lojtarët e tjerë që plotësojnë treshen e tyre. Nëse kjo listë e Van Persiet vihet në lojë, do të ishte hera e parë që nga viti 2006 që as Messi dhe as Ronaldo nuk janë pjesë e top treshes. Që nga viti 2007, duke përmendur edhe vitin 2018, janë herët e vetme që Ronaldo apo Messi nuk kanë fituar "Topin e Artë". Lewandowski, De Bruyne dhe Mane asnjëherë nuk kanë qenë pjesë e top treshes për "Topin e Artë".

De Rossi: Jam gati për të drejtuar një skuadër

Ish-mesfushori i Romës, Dabiele de Rossi, ka thënë se është i gatshëm për të drejtuar një skuadër. Ai tashmë e ka formuar edhe stafin me të cilin po punon në avancë për të qenë i përgatitur ta shfrytëzojë maksimalisht çdo mundësi që u jepet. "Të ardhmen e shoh si trajner dhe mund të them se që tani kam stafin tim, me të cilin ndjekim ndeshje të ndryshme e përgatitemi. Është një punë e vështirë, ndaj duam të jemi gati ta shfrytëzojmë maksimalisht mundësinë e parë që do të na jepet", ka deklaruar De Rossi, i cili është kontaktuar nga skuadra e Fiorentinës.

Pogba: Unitedi është klubi më i madh anglez

Mesfushori i Manchester Unitedit, Paul Pogba, beson se Djajtë e Kuq mbeten klubi më i madh në Angli, përderisa ka thënë se po e shijon mundësinë ta shikojë Bruno Fernandesin në "Old Trafford". "Unë po e shijoj mundësinë t'i shoh Brunon, Rashfordin, Martialin dhe Mason. Të gjithë ata luajtën në ndeshjen e fundit dhe i pashë të gjithë duke shënuar. E gjitha që mund ta bësh është të duartrokasësh, është e bukur... ata bëjnë që unë ta shijoj futbollin çdoherë", ka thënë fillimisht Pogba. Më tutje, Pogba u shpreh se Manchesteri është një klub që ka qëllim që gjithmonë të përmirësohet dhe të mos jetë i kënaqur asnjëherë me vete. "Ne duhet ta kemi gjithmonë qëllim të përmirësohemi dhe të mos jemi të kënaqur kurrë me atë që e kemi bërë. Ky është mentaliteti i këtij klubi, ka qenë gjithmonë kështu. Nuk je i kënaqur kurrë me një trofe apo me një fitore, gjithmonë kërkon më shumë. Kjo e bën Manchester Unitedin klubin më të madh në Angli, sipas meje", ka përfunduar Pogba.

SHPLLJE PËR SHITJE

Ndërmarrja e Re "MIM Golesh" Magure

Ndërmarrja e Re (N.R.) "MIM Golesh", Magure e cila është në Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së, **SHPLLË** këtë:

FTESË PËR OFERTË
PËR SHITJEN E MATERIALVE

EMRI ZYRTAR: Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"

ADRESA POSTARE: Magure

I. LËNDA E KONTRATËS;

Autoriteti kontraktues ka për qëllim shitjen e materialeve si vijon:

1. Dunit I thërrmuar, fraksion 0 – 4mm , rreth 13800 m³,
2. Dunit I thërrmuar, fraksion 4 – 8 mm , rreth 2500 m³,
3. Dunit I thërrmuar, fraksion 8 – 11 mm rreth 1100 m³ dhe
4. Shkëmbinj ultrabazik (material për mbushje), fraksion – 60 mm , rreth 36700 m³

II. KUSHTET E OFERTIMIT:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit, numrit fiskal, certifikata e TVSH-se, numrin e telefonit kontaktues dhe adresa. Oferta duhet të përmbaj çmimin me TVSH, duhet të jete shume e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuara, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

III. VIZITA E MATERIALEVE

Palët e interesuara, materialet e larte cekura mundë ti shikojnë prej datës 07.07.2020 deri me 12.07.2020 prej orës 10:00h deri në orën 14:00h përmes personit kontaktues z. Shefik Imeri, nr. tel mob. 049/455-869 ose fix. 038/588-700.

IV. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES:

1. Çmimi më i lartë i ofruar për m³ të materialit

V. AFATI KOHOR DHE VENDI PER DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen me datën **13.07.2020** nga ora **13⁰⁰** deri në orën **14⁰⁰** në adresën e mëposhtme: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.

Ofertat do të hapen me datë **13.07.2020** në ora **14¹⁰** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08,.

VI. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.

>> SHPLLJE TË VOGLA <<

► Aksa Beyza Kryemadh shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Abdyl Frashëri " Prizren .

► Qendresa Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Ibrahim Fehmiu " Prizren .

► Belma Gjinali shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - X shf " Mustafa Bakui " Prizren.

► Nazmi Maxhera shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.

► Vaxhid Zahiri shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. "Ekonomike" Marin Barleti" Gjilan.

► Ard Qazimi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Thimi Mitko" Gjilan, kl. VI-IX.

► Venera Shkodra shpall të pavlefshme dëftesën e SH.M.M. "Asllan Elezi kl.X,XI,XII dhe diplomën.

► Mevlide Mehmeti shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SH.M.M "Asllan Elezi" Gjilan, kl. X.XI.XII.

► Diellza Ymeri shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e kl. X.XI.XII. shkolla e mesme e mjekësisë "A. Elezi" Gjilan.

► N.T.SH. Online B.I. shpall të pavlefshme nr. e biznesit me nr. 80706405 Viti.

► Flamur Kamberi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. XI (njëmbëdhjetë) SH.M. "Arbeni Gjilan.

► Alvin A. Isufi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Selami Hallaqi" kl.VI-IX Gjilan.

► Meriton Veseli shpall të pavlefshme dëf. E kl. X.XI.XII. DHE diplomën SH.M. "Arbëria" Gjilan.

► Ervin M Haziri shpall të pavlefshme def. E kl. X.XI.XII cartifik dhe diplomën e SH.M.M. "Asllan Elezi" Gjilan.

► Faruk .I. Muzliu shpall të pavlefshme diplomën 29.05.55. sh. Mesme Teknike Gjilan.

► Arjeta Bunjaku shpall të pavlefshme dëftesat e kl.X.XI.XII.XII, certifikatën dhe diplomën SH.M.M. "Asllan Eleziligjan.

► Xheneta Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Marin Barleti" Gjilan.

► Fatlinda Ademi shpall të pavlefshme dëft. E kl. X.XI.XII.XIII certifikatën dhe diplomën SH.M.M "Asllan Elezi"

► Ridvan N. Musliu shpall të pavlefshme dëftesën e kl.X . sh. M. M. "Asllan Elezi" Gjilan.

► Sebahate Haziri shpall të pavlefshme licencën e punës Nr. KO-0797-05-1 Prishtinë.

► Egzon Otollishpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Memet Isai" Gjilan.

► Lendrit Ahmeti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ramiz Cernica" Cernic kl. I deri IX.

► Fitim B. Dauti shpall të pavlefshme dëf. Kl. X.XI.XII.XIII. cartifikatën dhe diplomën e SH.M.M. "Asllan Elezi".

► The Living-Room SH.P.K. shpall të pavlefshme nr. e regjistrimit të biz. 810052407 B. Berisha.

► Hesat Shahini shpall të pavlefshme def. E shkollës fillore të kl/VIII "Nazim Hikmeti" Dobercan.

► Zyrafete Hashini shpall të pavlefshme def. E shkollës fillore. Kl.I deri VIII Dobercan "Nazim Hikmet"

► Nora Sherifi B.I. shpall të pavlefshme nrb. 330116477 Gjilan.

► Liridona I. Rahmani shpall të pavlefshme def. e SH,M,M.A. ELEZI të kl.X.XI.XII.XIII certifikatën dhe diplomën Gjilan.

► Liridona Xhemali shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Marin Barleti" Gjilan.

► Ermedina SH.P.K. shpall të pavlefshme nr. biz. 811011640 Gjilan pronare Ermedina Selishta.

► Suad.M. Arifi shpall të pavlefshme dëf. E kl.X.XI.XII. certifikatën dhe diplomën e SH.M.M "Asllan Elezi" Gjilan.

► Belgize Rahimi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore"Abdulla Tahiri"Malishevë.kl.I-VIII

► Belgize Rahimi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m. Teknike "Mehmet Isai" Gjilan. Kl.I.I.III.IV-diplomen.

► A-Techology. SH.P.K. mbyll biznesin me nr. 810192534 Gjilan.

► N.T.P "Adhurimi" shpall të pavlefshme nr. e biz. 70098906 Gjilan.

► Balerina. Sh. Lenjani shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.M. "Asllan Elezi" Gjilan.

► Kaltrin Isufi shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.M "Asllan Elezi" Gjilan.

► D.P.T. "Mili" shpall të pavlefshme nr. e biz. 7009720 Gjilan.

► Liridona Rahmoni shpall të pavlefshme certifikatën e SH.M.M. "Asllan Elezi" Gjilan.

► Arbër Sylejmani shpall të pavlefshme dëft. E kl.I-XI.XII diplomën SH.M. Gjim " Xhavit Ahmeti" Gjilan.

► Bajrush . A. Hasani shpall të pavlefshme dëftesën e sh. Fillore "Musa Zjani"te kl. I-VIII, Gjilan.

► Abdylaziz Sherifi shpall të pavlefshme dëfte. Shkollës fillore "Ramiz Cernica" të kl. I-VIII Gjilan.

► Mustafa Z. Muji shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X.XI.XII carti. Diplomën Shkoll mesme Teknike "Mehmet Isai" Gjilan.

► Biznesi individual shpall të pavlefshme nr. e regj. Biznesit me nr. 71238865 Ahmet Hasani.

► Ruzhdi I. Adrazaj shpall të pavlefshme dëft e shkollës fillore "Skënderbeu" Hogosht të kl. I-VIII.

► Adelina G. Mustafa B.I. shpall të pavlefshme nr. e biz. Me nr. 810058504.

► Naser Abazi shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E. "Marin Barleti" Gjilan.

► Elviana S. Blaca shpall të pavlefshme INDEX-IN me nr. 03/16998 Kolegji FAMA drejtimi Infermeri.

► Autoshkolla "Trimi" SH.P.K. NR. Unik 811384932 Gjilan për arsye të pandemisë COVID19-bënë zbritje 30% për regjistrim të kandidatëve.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Mehdi Gjoka” B.I. Tërstenik, Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve – deponimin e naftës në rezervuar cilindrik (vertikal) $V=3000m^3$.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.08.2020 në ora 13:30 në hapësirat e objektit “Drini Company” kati 5, rruga Joni p.n. Prizren do të organizohet debat publik nga kompania “Mehdi Gjoka” B.I. Tërstenik, Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve – deponimin e naftës në rezervuar cilindrik (vertikal) $V=3000m^3$.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM (Personal Meeting ID :9662771284 , Paswordi : 112233)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” FAKULTETI JURIDIK

Në pajtim me nenin 127 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, nenin 17.4 të Rregullores për Studimet e Doktoratës, si dhe Vendimin (nr. 1/355) të Senatit të Universitetit të Prishtinës, Zyra për Shërbime Postdiplomike e Fakultetit Juridik, shpallë këtë:

NJ O F T I M

Me të cilin njoftohen të interesuarit se me datën 20.07.2020, në orën 13:00 në hapësirat e Fakultetit Juridik do të organizojë mbrojtjen publike të Disertacionit të Doktoratës të kandidatit Ma.sc. Arbnor Ajeti, me titull: “Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën kontestimore” me Mentor: Prof. Asoc. Dr. Rustem Qehaja, para Komisionit Vlerësues në përbërje: Prof. Dr. Iset Morina (Kryetar); Prof. Asoc. Dr. Haxhi Gashi (Anëtar); Prof. Dr. Mariana Semini (Anëtare).

Prishtinë, 09.07.2020

Suzana Gusija

**Zyrtare për Shërbimin e Studimeve të Doktoratës
Fakulteti Juridik**

Produkte Bio natyrale **MATI**



Mati -com Sh.P.K. është ndërmarje prodhuese vendore e cila prodhon dhe përpunon qumësht të dhisë dhe lopës

Fabrika për prodhimin dhe përpunimin e qumështit të Dhisë dhe Lopës

Email: mati-com@outlook.com
tel: +386 49 288-340
Kijevë-Malishevë

An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

N.N.P.Mati Com SHPK



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues